

KOMPETENCA THEMELORE PROFESIONALE *dhe* STANDARDE PËR ARSIMTARË



**KOMPETENCA
THEMELORE
PROFESIONALE
dhe STANDARDE
PËR ARSIMTARË**



Projekt për Zhvillim Profesional
dhe në Karrierë të Arsimitarëve



Botimi është përpiluar me mbështetje eksperte dhe financiare të Projektit të USAID-it për Zhvillim Profesional dhe në Karrierë të Arsimitarëve, i realizuar nga Qendra Maqedonase për Edukim Qytetar (QMEQ) në bashkëpunim me Byronë e Zhvillimit të Arsimit (BZHA).

Botimi është përpiluar nga grupi i punës i përbërë prej përfaqësuesve të: Byrosë për Zhvillimin e Arsimit, Qendrës për Edukim Profesional dhe Trajnim, fakulteteve për arsimtarë, si dhe arsimtarë dhe praktikues në shkollat fillore dhe të mesme në Republikën e Maqedonisë. Si partner i projektit është përfshirë edhe *Fondacioni për nisma arsimore dhe kulturore "Hap pas hapi"*.

Përmbajtja e dokumentit nuk i reflekton qëndrimet e Agjencisë së SHBA-ve për Zhvillim Ndërkombëtar ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Titulli

KOMPETENCA THEMELORE PROFESIONALE DHE STANDARDE PËR ARSIMTARË

Botues

Qendra Maqedonase për Edukim Qytetar (QMEQ)

Përkthimi

Enis Misini

Dizajn

KOMA

Shtypshkronja

Vinsent grafika

Tirazhi

630

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

37.011.3:005.962.131

KOMPETENCA themelore profesionale dhe standarde për arsimtar /
[përkthimi Enis Misini]. - Shkup : Qendra maqedonase për edukim
qytetar (QMEQ), 2016. - 79 стр. : илустр. ; 30 см

Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-4529-35-4

а) Наставници - Компетентност

COBISS.MK-ID 101306890

PËRMBAJTJE

PARATHËNIE 5

Struktura e kompetencave themelore profesionale
dhe standardeve profesionale për arsimtar – mentor
dhe për arsimtar – këshilltar.....6

Vlera profesionale të arsimtarëve7



KOMPETENCA THEMELORE PROFESIONALE PËR ARSIMTARË 11

I. NJOHURI PËR LËNDËN MËSIMORE DHE PËR SISTEMIN EDUKATIVO-ARSIMOR	13
II. MËSIMDHËNIE DHE NXËNIE	17
III. KRIJIM I MJEDISIT STIMULUES PËR NXËNIE	25
IV. INKLUZION SOCIAL DHE ARSIMOR	29
V. KOMUNIKIM DHE BASHKËPUNIM ME FAMILJEN DHE BASHKËSINË.....	31
VI. ZHVILLIM PROFESIONAL DHE BASHKËPUNIM PROFESIONAL.....	33



STANDARDE PROFESIONALE PËR ARSIMTAR – MENTOR..... 37

PIKËNISJE PËR PËRPILIMIN E STANDARDEVE PËR ARSIMTAR-MENTOR	39
I. NJOHURI PËR LËNDËN MËSIMORE DHE PËR SISTEMIN EDUKATIVO-ARSIMOR	41
II. MËSIMDHËNIE DHE NXËNIE	43
III. KRIJIM I MJEDISIT STIMULUES PËR NXËNIE	47
IV. INKLUZION (PËRFSHIRJE) SOCIAL DHE ARSIMOR.....	49

V. KOMUNIKIM DHE BASHKËPUNIM ME FAMILJEN DHE BASHKËSINË.....	51
VI. ZHVILLIM PROFESIONAL DHE BASHKËPUNIM PROFESIONAL.....	53



STANDARDE PROFESIONALE PËR ARSIMTAR – KËSHILLTAR.....57

PIKËNISJE PËR PËRPILIMIN E STANDARDEVE PËR ARSIMTAR-KËSHILLTAR.....	59
I. NJOHURI PËR LËNDËN MËSIMORE DHE PËR SISTEMIN EDUKATIVO-ARSIMOR	61
II. MËSIMDHËNIE DHE NXËNIE	63
III. KRIJIM I MJEDISIT STIMULUES PËR NXËNIE	67
IV. INKLUZION (PËRFSHIRJE) SOCIAL DHE ARSIMOR.....	69
V. KOMUNIKIM DHE BASHKËPUNIM ME FAMILJEN DHE BASHKËSINË.....	71
VI. ZHVILLIM PROFESIONAL DHE BASHKËPUNIM PROFESIONAL.....	73

PARATHËNIE

Hulumtime të shumta tregojnë se përvojat në nxënien dhe të arriturat e nxënësve në masë të madhe varen nga njohuritë, aftësitë, shkathtësitë dhe përkushtimi i arsimtarëve të tyre. Qëllimi themelor i punës edukativo-arsimore të arsimtarëve është që nxënësit t'i zhvillojnë maksimalisht potencialet e tyre. Që të arrihet ky qëllim është e domosdoshme që arsimtarët të posedojnë kompetenca për punë cilësore edukativo-arsimore dhe të kenë mundësi të përsosjen në mënyrë profesionale dhe avancohen gjatë karrierës.

Mosekzistimi i kompetencave dhe standardeve të përkufizuara qartazi për arsimtarët ishte identifikuar si një nga hallkat e dobëta të sistemit për zhvillim profesional dhe në karrierë të arsimtarëve në Republikën e Maqedonisë.¹ Me qëllim që kjo situatë të tejkalohet, me *Ligjin për arsimtarë në shkollat fillore dhe të mesme*² janë rregulluar kompetencat themelore profesionale për arsimtarët (kapitulli III), zhvillimi profesional (kapitulli IV) dhe zhvillimi në karrierë (kapitulli V) i arsimtarëve, ndërsa në mënyrë më të detajuar janë rregulluar me aktet nënligjore.

Kompetencat themelore dhe standardet profesionale³ për arsimtar-mentor dhe arsimtar-këshilltar që janë dhënë në këtë dokument i përpiloi grupi punues i përbërë nga ekspertë në arsim, profesorë universitarë, arsimtarë, këshilltarë të Byrosë për Zhvillim të Arsimit (BZHA) dhe Qendrës për Arsim Profesional dhe Trajnim (QAPT). Me këtë rast, grupi punues i kishte parasysh *Parimet e përbashkëta evropiane për kompetenca dhe kualifikime të arsimtarëve*⁴ dhe kompetencat dhe standardet për

avancim në karrierë të arsimtarëve në një numër më të madh të vendeve, si dhe parimet në të cilat mbështetet arsimi në Republikën e Maqedonisë. Versioni fillestar ishte bazë për konsultime me një rreth të gjerë të përfaqësuesve të fakulteteve për arsimtarë, mësimdhënës të shkollave fillore dhe të mesme, bashkëpunëtorë profesional në shkolla dhe drejtorë të shkollave, si dhe përfaqësues të institucioneve që janë kompetente për sigurimin e cilësisë në arsim. Të gjithë këta kontribuuan për cilësinë e versionit final të dokumentit.

Kompetencat dhe standardet themelore profesionale për arsimtar-mentor dhe arsimtar-këshilltar pritet të kontribuojnë për mësim dhe nxënie më cilësore në shkollë dhe për të arritura më të larta të nxënësve përmes vendosjes së pritjeve të qarta dhe të larta nga arsimtarët, si dhe dallimin dhe vlerësimin e zhvillimit të tyre profesional dhe angazhimin profesional. Me konkretisht, ato do të përdoren për:

- Përpilim të standardit për kualifikim profesional për arsimtar;
- Harmonizim të arsimit universitar me kompetencat e nevojshme të arsimtarëve;
- Planifikim të hyrjes në punë dhe dhënies së mbështetjes së mentorit;
- Përkufizim të përmbajtjes dhe mënyrës së dhënies së provimit profesional dhe marrjes së licencës për arsimtar;
- Planifikim të zhvillimit profesional, si atë personal, ashtu edhe në nivel të shkollës, rajonit, shtetit;
- Përpilim të procedurave dhe instrumenteve për ndjekjen e punës së arsimtarëve dhe dhënien e mbështetjes profesionale;
- Përpilim të procedurave dhe instrumenteve për vlerësimin e punës së arsimtarëve, të cilët kanë aplikuar për titujt arsimtar – mentor dhe arsimtar – këshilltar;
- Përpilim të katalogëve të kompetencave për arsimtarë të caktuar (p.sh. edukator në institucion parashkollor, arsimtar klasor, arsimtar lëndor, arsimtar i lëndës profesionale ose madje edhe për arsimtarë të lëndëve të caktuara);
- Përmirësim të punës së institucioneve kompetente për ndjekjen, matjen dhe përmirësimin e cilësisë së punës së arsimtarëve dhe shkollave.

1 Analizë e politikave dhe praktikës së zhvillimit profesional dhe në karrierë të arsimtarëve në Republikën e Maqedonisë, USAID Projekt për Zhvillim Profesional dhe në Karrierë të Arsimtarëve, Qendra Maqedonase për Edukim Qytetar, gusht 2013.

2 Ligji për arsimtarë në shkollat fillore dhe të mesme, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 10/15).

3 Me kompetenca nënkuptohet përmbledhja e diturisë së përvetësuar, aftësive, shkathtësive dhe vlerave profesionale, gjegjësisht aftësi e dëshmuar për përdorimin e diturisë dhe shkathtësive në situata të nxënies ose të punës. Me standarde nënkuptohen kompetenca të nivelit më të lartë që duhet të posedohen, me qëllim që të arrihet një titull i caktuar në avancim në karrierë.

4 Common European Principles for Teacher Competences and Qualifications, http://ec.europa.eu/education/policies/2010/doc/principles_en.pdf.

STRUKTURA E KOMPETENCAVE THEMELORE PROFESIONALE DHE STANDARDEVE PROFESIONALE PËR ARSIMTAR – MENTOR DHE PËR ARSIMTAR – KËSHILLTAR

Kompetencat dhe standardet janë përpiluar në atë mënyrë që *Kompetencave themelore profesionale* u shtohen standardet për arsimtar-mentor, ndërsa standardeve për arsimtar-mentor u shtohen standardet për arsimtar-këshilltar. Më konkretisht, për pozitën arsimtar-mentor duhet të posedohen kompetencat themelore profesionale dhe standardet për arsimtar-mentor, kurse për arsimtar-këshilltar duhet të posedohen standardet për arsimtar-mentor dhe standardet për arsimtarë-këshilltar.

Në këtë dokument, kompetencat dhe standardet janë të ndara vetëm teknikisht në tri pjesë:

- Kompetenca themelore profesionale për arsimtarë
- Standarde profesionale për arsimtar – mentor
- Standarde profesionale për arsimtar – këshilltar

Kompetencat dhe standardet profesionale kanë të bëjnë me:

VLERA PROFESIONALE, që pritet t'i posedojë dhe respektojë secili arsimtar. Ato në këtë dokument janë veçuar para pjesëve tjera për arsye se kanë të bëjnë me të gjithë arsimtarët.

KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE, SI DHE AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE, që pritet arsimtari t'i ketë përvetësuar gjatë arsimimit për mësimdhënës dhe gjatë viteve të para të punës edukativo-arsimore, ndërsa ato për arsimtar-mentor dhe arsimtar-këshilltar edhe gjatë punës së mëtejshme dhe zhvillimit profesional.

Kuptimet, njohuritë, aftësitë dhe shkathtësitë profesionale janë grupuar në fushat vijuese:

- I. Njohuri për lëndën mësimore dhe për sistemin edukativo-arsimor
- II. Mësimdhënie dhe nxënie
- III. Krijim të mjedisit stimulues për nxënie
- IV. Inkluzion (Përfshirje) social dhe arsimor
- V. Komunikim dhe bashkëpunim me familjen dhe bashkësinë
- VI. Zhvillim profesional dhe bashkëpunim profesional

Në secilën fushë, krahas përshkrimeve të kuptimeve dhe njohurive profesionale dhe aftësive dhe shkathtësive profesionale është shtuar edhe kolona **Shembuj të praktikës profesionale**. Shembujt e praktikës profesionale do të ndihmojnë që një kompetencë e caktuar të jetë e kuptuar në mënyrë të njëjtë dhe e ndjekur dhe vlerësuar me "sy të njëjtë" nga vetë arsimtari, institucionet që janë kompetente për vëzhgimin e zhvillimit të tij dhe institucionet për kontrollin e vlefshmërisë së zhvillimit profesional të arsimtarëve. Shembujt e përmendur të praktikës profesionale do të ndihmojnë në dallimin e cilësisë lidhur me të arriturat e arsimtarit në nivel të shkollës dhe në bashkësinë lokale, por edhe për vetëvlerësimin e praktikës personale. Këto paraqesin bazë për përpilimin e procedurave dhe instrumenteve për avancim në titullin arsimtar-mentor, gjegjësisht arsimtar-këshilltar.

VLERA PROFESIONALE TË ARSIMTARËVE

Vlerat profesionale dhe bindjet e arsimtarëve për nxënien, mësimdhënien dhe profesionin e arsimtarit janë parime udhëheqëse që përcaktojnë se çfarë vendimesh profesionale do të marrë arsimtari, gjegjësisht si do ta planifikojë dhe realizojë mësimdhënien, si do të silllet ndaj nxënësve, prindërve, kolegëve dhe bashkësisë më të gjerë. Qëndrimet dhe vlerat profesionale përfitohen dhe ndryshohen gjatë studimeve për arsimtar, përmes zhvillimit profesional dhe përmes praktikës. Ato janë bazë për zhvillimin e kompetencave, e veçanërisht për shfrytëzimin e tyre në punën profesionale. Pritet që arsimtari t'i ketë aprovuar dhe të silllet në pajtim me vlerat profesionale:

SECILI NXËNËS MUND TË MËSOJË DHE TË ZHVILLOHET

Arsimtari beson se, ndonëse nxënësit janë individë të veçantë dhe dallojnë sipas aftësive, qasjes në nxënie, sipas përvojës, interesave dhe motivimit, të gjithë mund të mësojnë dhe të zhvillohen. Është i bindur se potencialet e nxënësve do të zhvillohen, nëse nxënësit janë të motivuar të bëjnë përpjekje përkatëse, që do të rezultojë me ndjenjën e suksesit. Kjo do ta forcojë vetëbesimin dhe motivimin për nxënie. Konsideron se, nëse mësimi u del në ndihmë interesave dhe nevojave të nxënësve dhe mundëson marrjen e njohurive që janë relevante për ta, ata do të mësojnë me kënaqësi dhe me përkushtim dhe do të mendojnë për potencialet e tyre, si dhe për gjërat që mund të përmirësohen, ndërsa kjo do t'u ndihmojë që të zhvillohen si individë të suksesshëm dhe anëtarë të bashkësisë.

NXËNIE E PËRJETSHME

Arsimtari e fillon karrierën e vet me bindjen se profesioni i mësimdhënies është dinamik dhe se ai duhet vazhdimisht të përsoset për të qenë në rrjedhë me njohuritë e reja në sferën e mësimdhënies, me qasjet e reja për punë me nxënësit dhe me ndryshimet në qëllimet dhe pritjet e shoqërisë lidhur me arsimin. Ai konsideron se mësimi

nuk është punë rutinë dhe se ofron shumë mundësi për nxënie dhe zhvillim profesional. Vetveten e shih si përgjegjës për nxënien dhe zhvillimin e tij profesional, ndërsa vetë-refleksionin e konsideron si mënyrë më të përshtatshme për përmirësim. Suksesin e kupton si proces të nxënies dhe zhvillimit të vazhdueshëm, ndërsa nxënien e vazhdueshme nuk e shikon vetëm si mënyrë për të qenë në rrjedhë me ndryshimet ekzistuese, por edhe si hap drejt suksesit. Beson se, nëse tregon entuziazëm për nxënie në sferën e mësimin dhe në profesionin e tij, do të paraqesë model pozitiv për nxënie të përvetshme edhe për nxënësit edhe për kolegët.

INTEGRITETI PROFESIONAL DHE PËRKUSHTIMI NDAJ PROFESIONIT TË ARSIMTARIT

Arsimtari i suksesshëm, e do profesionin e tij, dëshiron të punojë me fëmijë dhe të rinj, beson në mundësitë e tyre dhe gëzohet me sukseset që ata i arrijnë. Është i bindur se mësimdhënësi nuk është vetëm ligjërues i një lënde përkatëse, por ai duhet të tregohet i kujdesshëm për zhvillimin e përgjithshëm të nxënësve, të jetë i hapur për komunikim dhe ndihmë dhe t'u ofrojë mbështetjen që u nevojitet. Arsimtari beson se profesioni që e ushtron është i rëndësishëm jo vetëm për nxënësit, por edhe për shoqërinë dhe beson se ndryshimet pozitive të nxënësit shpijnë drejt ndryshimeve pozitive në shoqërinë si tërësi. Konsideron se pa marrë parasysh se sa është diçka e mirë, gjithmonë mund të jetë edhe më mirë, ndaj për këtë arsye sfidat në profesionin e shikon si mundësi për gjetjen e zgjidhjeve inventive, ndërsa punën në projekte zhvillimore dhe hulumtuese si mundësi për përmirësimin e politikave dhe praktikave arsimore. Integritetin profesional dhe personal nuk e shikon vetëm si veti të tij, por edhe si mënyrë për promovimin e profesionit të arsimtarit në shoqërinë. Kur është i përballur me presione të ndryshme, arsimtari nuk u nënshtrohet atyre, por udhëhiqet sipas parimeve profesionale.

BASHKËPUNIM

Arsimtari konsideron se për nxënie dhe zhvillim të suksesshëm të nxënësit është me rëndësi që të vendoset marrëdhënie partneriteti mes arsimtarit, shkollës,

familjes dhe bashkësisë më të gjerë. Me këtë rast, mësimitdhënësit do të shkëmbejnë qëllime të njëjta për mësimin e nxënësve, do të shkëmbejnë informacione, do të merren vesh për qasje dhe strategji, do të plotësojnë njëri-tjetrin, ndërsa komunikimi i tyre do të mbështetet në respekt dhe besim të ndërsjellë. Arsimtari beson se marrëdhëniet me prindërit janë kryesore për shkak se komunikimi i rregullt dhe i dyanshëm është në interes të zhvillimit dhe nxënies së fëmijës së tyre, por edhe në interes të bashkësisë më të gjerë shkollore. Është i bindur se përmes bashkëpunimit profesional me kolegët dhe me bashkësinë më të gjerë mund të kontribuojë për të arritura më të larta të nxënësve, afirmim të shkollës dhe ngritje të arsimit në nivel të bashkësisë.

BARAZI, INKLUZION (PËRFSHIRJE) DHE DREJTËSI SOCIALE

Arsimtari është i ndjeshëm ndaj nxënësve të ndryshëm dhe tregon gatishmëri për t'i pranuar nxënësit si personalitete të veçanta, të ndryshme nga të tjerët, pa marrë parasysh aftësitë e tyre. Beson se nxënësit do të duan të mësojnë dhe do të mësojnë nëse ndjehen të pranuar në klasë dhe shkollë dhe synon të krijojë mjedis në të cilin çdo diversitet pranohet dhe respektohet. Është i përkushtuar në mbështetjen e zhvillimit individual, mirëqenies dhe përfshirjes në bashkësinë më të ngushtë dhe më të gjerë të secilit nxënës, pa dallim të aftësive ose prejardhjes dhe në ngritjen e vetërespektit dhe vetëbesimit.

Konsideron se dokumentet për të drejtat e njeriut dhe fëmijëve dhe kundër diskriminimit, si dhe parimet e drejtësisë sociale, duhet të zbatohen në mënyrë konsekuente në përditshmëri dhe këtë e tregon përmes marrjes së vendimeve të drejta dhe korrekte.

ANGAZHIMI NË SHKOLLË

Kjo vlerë profesionale pritet të manifestohet fuqishëm tek arsimtarët - mentor. Ata, përveç që punojnë me përkushtim me nxënësit dhe kolegët brenda detyrave të rregullta, gjithashtu ndejnë një lidhje të fortë me shkollën në të cilën punojnë dhe besojnë se të gjithë duhet dhe mund të kontribuojë në promovimin e shkollës. Arsimtari - mentor beson që me iniciativën dhe angazhimin e tij mund të kontribuojë në përmirësimin e punës së kolegëve të tij, ofron dhe është i gatshëm të jep mbështetje dhe ndihmë për të gjithë ata që kanë nevojë. Është i bindur se shkolla është një vend ku mësimitdhënësit mësojnë dhe kështu paraqesin një shembull motivues për nxënësit, prindërit dhe komunitetin më të gjerë. Ai punën e tij e sheh përtej angazhimeve bazë në mësimitdhënie dhe aktiviteteve jashtëmësimore dhe me kënaqësi angazhohet në aktivitete të ndryshme për avancimin e punës në të gjithë shkollën.

ANGAZHIMI PËR PËRMIRËSIMIN E MËSIMDHËNIES NË NIVEL SHKOLLË

Kjo vlerë profesionale pritet të manifestohet tek arsimtarët - këshilltarë. Arsimtari-këshilltar në zhvillimin e tij profesional ka arritur deri në atë nivel që të ndjehet i aftë dhe i përgjegjshëm për të kontribuar në avancimin e mësimitdhënies edhe jashtë kornizave shkollore, në nivel rajonal dhe kombëtar. I pranon qasjet e reja (inovative), është i informuar për tendencat moderne arsimore, në mënyrë kritike analizon praktikën edukativo-arsimore dhe beson se mund të kontribuojë në përmirësimin e saj në nivel kombëtar dhe ndërmerr iniciativa në këtë drejtim.



**KOMPETENCA
THEMELORE
PROFESIONALE
për ARSIMITARË**

NJOHURI PËR LËNDËN MËSIMORE DHE PËR SISTEMIN EDUKATIVO-ARSIMOR

Njohuritë teorike dhe praktike të arsimtarëve për lëndën dhe disiplinat në të cilat i mësojnë nxënësit, njohuritë, vlerat dhe shtrirjen e sistemit edukativo-arsimor të Republikës së Maqedonisë, janë kompetenca fillestare që duhet t'i posedojë secili arsimtar.

Nga arsimtari pritet që ta dijë mirë bazën përmbajtësore të lëndës, ta kuptojë strukturën e saj të ndryshueshme, t'i gjejë, lidhë dhe plotësojë përmbajtjet me lëndë tjera mësimore. Ai, po ashtu, duhet t'i njohë dhe t'i shfrytëzojë mënyrat më adekuate për realizimin e mësimin nga lënda përkatëse, përmes të cilave do ta bëjë lëndën interesante dhe tërheqëse për nxënësit.

Me njohjen dhe respektimin e akteve ligjore dhe profesionale-normative, arsimtari siguron realizimin e qëllimeve të edukimit dhe arsimit.

I. NJOHURI PËR LËNDËN MËSIMORE DHE PËR SISTEMIN EDUKATIVO-ARSIMOR

Nën-fusha: NJOHURI PËR LËNDËN MËSIMORE

ARSIMTARI... 

A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
<ol style="list-style-type: none">1. Njeh materien e lëndës në të cilën ju ligjëron nxënësve dhe e di se si ajo është e ndërlidhur me lëndët tjera mësimore.2. Njeh nocionet kryesore të lëndës mësimore dhe lidhshmërinë e tyre.3. Ndjek njohuritë e reja nga lënda mësimore.4. Ndjek të arriturat më të reja tekniko-teknologjike në profesion⁵.5. Kupton rëndësinë e lidhshmërisë së arsimit profesional me nevojat e tregut të punës⁵.6. Kupton lidhshmërinë ndërmjet përmbajtjeve mësimore dhe zhvillimit në karrierë të nxënësve.7. Njeh planin dhe programin mësimor dhe marrëdhëniet mes komponentëve të tyre (p.sh. qëllime, përmbajtje, drejtime didaktike, kuptime, aktivitete).8. Njeh metodat themelore për hulumtim në sferën shkencore të cilës i takon lënda mësimore.	<ol style="list-style-type: none">1. Njohuritë e reja nga lënda mësimore, në mënyrë përkatëse i përfshinë në mësimdhënien.2. Është i përqendruar në realizimin e qëllimeve të lëndës mësimore.3. Bashkon njohuritë rreth nocioneve kryesore të lëndës mësimore.4. Ndërlidhë përmbajtjet mësimore që të arrihen qëllimet ndërlëndore gjatë të gjitha aktiviteteve edukativo-arsimore.5. Shfrytëzon metoda, teknika dhe instrumente për aftësimin e nxënësve për vetëprezantim.6. Ndërlidhë qëllimet e mësimin me të arriturat më të reja tekniko-teknologjike në profesionin dhe nevojat e tregut të punës⁵.7. Tek nxënësit shkakton interes për lëndën mësimore.8. Te nxënësit ndërton raport kritik ndaj materies së lëndës mësimore dhe i ndihmon ata ta vlerësojnë materien e lëndës nga aspekti shkencor.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Organizon në mënyrë efektive përmbajtjet mësimore në pajtim me nocionet kryesore dhe qëllimet e parashtruara.
- Shfrytëzon dhe i udhëzon nxënësit që të shfrytëzojnë njohuri bashkëkohore nga lënda mësimore.
- Në mësim përfshin njohuritë më të reja nga sfera e të arritave tekniko-teknologjike në profesion⁵.
- Në nxënie dhe mësimdhënie përfshin aktivitete për integrimin e përmbajtjeve dhe për arritje të qëllimeve ndërlëndore.
- Ndihmon nxënësit në hartimin e biografisë së shkurtër, përgatitjen e letrës së motivimit dhe kalimin e intervistës (për pranim në organizatë, për punë, etj.).
- Në mësimdhënie dhe nxënie shfrytëzon metoda që i udhëzojnë nxënësit të hulumtojnë, analizojnë, vlerësojnë.

⁵ Këto kompetenca kanë të bëjnë vetëm me arsimtarët e mësimin praktik dhe lëndët profesionale-teorike në shkollat e mesme profesionale.

I. NJOHURI PËR LËNDËN MËSIMORE DHE PËR SISTEMIN EDUKATIVO-ARSIMOR

Nën-fusha: NJOHURI PËR SISTEMIN EDUKATIVO-ARSIMOR

ARSIMTARI...




A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
<p>9. Njeh sistemin arsimor, veçanërisht nënsistemin e arsimit në të cilin punon, duke përfshirë edhe rregulloren ligjore.</p> <p>10. Njeh dokumentet programore për nënsistemin e arsimit në të cilin punon.</p> <p>11. Kupton tendencat bashkëkohore dhe arsimore.</p>	<p>9. Udhëhiqet sipas parimeve të përgjithshme të sistemit të edukimit dhe arsimit.</p>




SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Evidencën dhe dokumentacionin pedagogjik e udhëheq në pajtim me rregulloren ligjore.





II. MËSIMDHËNIE DHE NXËNIE

Kompetencat për mësimdhënie dhe nxënie janë bërthama e kompetencave të arsimtarëve. Ajo për çka mbahet mend arsimtari i mirë është mënyra në të cilën e realizon mësimin. Ai arsimtar i cili di ta bëjë mësimin interesant, t'i përfshijë në mënyrë aktive nxënësit në procesin e nxënies, të vendosë pritje të larta para nxënësve të tij dhe t'i motivojë që t'u përgjigjen atyre pritjeve, të hulumtojnë dhe t'i parashirojnë supozimet, mendimet dhe pikëpamjet e tyre, ai arsimtar që pranon dhe nxitë mënyra të ndryshme të zgjidhjes së problemeve, pret që nxënësit të nxjerrin konstatime dhe ta shqyrtojnë zbatimin praktik të njohurive, është arsimtar që zhvillon interes ndaj lëndës që e ligjëron dhe i përgatitë nxënësit e tij për jetë.

Arsimtari i mirë gjithmonë ka njohuri për zhvillimin kognitiv, socio-emocional dhe psiko-motorik të nxënësve të vetë. Këto njohuri i shfrytëzon për ta planifikuar dhe përshtatur mësimin sipas nevojave të tyre, ta mbrojë shëndetin e tyre psikik dhe fizik dhe t'u mundësojë zhvillim optimal. Për këtë qëllim vazhdimisht bashkëpunon me prindërit e nxënësve, me ç'rast informimi është i dyanshëm, me çka ndërtohet besimi dhe raporti i partneritetit.

Ndjekja e punës së nxënësve është proces që vazhdimisht duhet të zhvillohet dhe të jetë i përcjellë me informacion përkatës kthyes, proces i cili duhet të jetë në funksion të përmirësimit edhe të mësimdhënies edhe të nxënies. Duke i ditur nevojat e nxënësit, arsimtari do të mund t'i ndihmojë secilit nxënës – edhe atij që më vështirë përparon edhe atij që më shpejtë hapëron nëpër procesin e nxënies. Duke i nxitur nxënësit që të marrin pjesë në mënyrë demokratike në jetën e shkollës, arsimtari do të mundësojë përvetësim të vlerave dhe qëndrimeve, e jo vetëm të njohurive të nxënësit.

II. MËSIMDHËNIE DHE NXËNIE

Nën-fusha: PLANIFIKIM DHE PËRGATITJE E MËSIMIT

ARSIMTARI... 

A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
<ol style="list-style-type: none">1. I di komponentët për planifikim të suksesshëm të mësimit.2. Njih lloje të ndryshme të planifikimit të mësimit.	<ol style="list-style-type: none">1. Planifikon mësime dhe nxënien sipas programeve dhe standardeve të parashikuara dhe sipas nevojave të nxënësve.2. Planifikon mësimin që do të realizohet tek punëdhënësi⁶.3. Zgjedhë dhe përgatitë aktivitete, mjete mësimore, materiale punuese dhe instrumente për ndjekjen e nxënësve, në pajtim me qëllimet e planifikuara.4. Planifikon në bazë të reflektimit të punës personale dhe informacionit kthyes nga nxënësit.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Përpilon planifikim të niveleve të ndryshme (planifikime vjetore, tematike, ditore, etj.).
- Planifikon qëllime të qarta, të arritshme dhe qëllime të cilat janë sfida për nxënësit.
- Planifikon rezultatet e pritura nga aktivitetet.
- Planifikon format, metodat dhe strategjitë e mësimeve.
- Planifikon mjetet mësimore dhe materialet e punës që nevojiten për realizimin e përmbajtjeve mësimore, duke përfshirë edhe TIK-un.
- Krijon bazë të të dhënave, me punëdhënësin me të cilët mund të bashkëpunojë⁶.
- Përcakton qëllime nga programi mësimor që mund të realizohen tek punëdhënësi⁶.
- Harmonizon qëllimet dhe aktivitetet e mësimit me nevojat e punëdhënësit⁶.
- Së bashku me arsimtarë tjerë, planifikon korrelacionin dhe integrimin e lëndës së tij me lëndët dhe përmbajtjet tjera mësimore.
- Gjatë planifikimit i merr parasysh edhe kohën dhe resurset në dispozicion.
- Gjatë planifikimit i merr parasysh veçoritë e mjedisit lokal.
- Planifikon metodat, procedurat dhe instrumentet për përcaktimin e njohurive paraprake të nxënësve dhe për vëzhgimin e të arriturave të tyre.
- Planifikon aktivitetet e arsimtarit dhe të nxënësve.
- Bën reflektim i cili përmban shqyrtim të arritjeve të qëllimeve, vështirësive në të cilat është hasur dhe drejtime për përmirësim gjatë planifikimit të ardhshëm.

⁶ Këto kompetenca kanë të bëjnë vetëm me arsimtarët e mësimit praktik dhe lëndëve profesionale-teorike në shkollat e mesme profesionale.

II. MËSIMDHËNIE DHE NXËNIE

Nën-fusha: REALIZIM I MËSIMDHËNIES

ARSIMTARI... 

A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
<ul style="list-style-type: none">3. Njeh strategji bashkëkohore për realizimin e mësimdhënies.4. Njeh qasjet metodike që janë specifike për lëndën mësimore.5. Njeh teknologjinë arsimore specifike për lëndën.6. Posedon njohuri themelore metodike për përmbajtjet ndër-lëndore.	<ul style="list-style-type: none">5. Procesin e mësimdhënies dhe nxënies e përqendron tek nxënësi.6. Shfrytëzon qasje dhe metoda bashkëkohore që janë në pajtim me qëllimet e mësimin, nevojat dhe mundësitë e nxënësve.7. Përdorë mjete bashkëkohore mësimore dhe mjete ndihmëse.8. Aktivizon nxënësit me çështje të përpiluara mirë, të cilat nxisin procese më të larta mendore.9. Krijon dhe mirëmban mjedis të hapur dhe stimulues që nxitë hulumtim, nxënie dhe pavarësi.10. Tek nxënësit zhvillon shkathtësi për nivelet më të larta të menduarit dhe për zgjidhje të problemeve.11. Në mënyrë sistematike i përfshinë nxënësit në disiplinën shkencore.12. Ndërlidhë përmbajtjen e lëndës me lëndë dhe përmbajtje tjera, me zbatimin e tyre praktik në jetën e përditshme dhe përmbajtjet i bën relevante për nxënësit.13. Ndjekë tendencat për profesione të ndryshme dhe në mënyrë përkatëse i zbaton të dhënat në procesin e arsimit për karrierë.14. E bën mësimin interesant dhe nxitë interes tek nxënësit për nxënie të lëndës mësimore.15. Mësimdhënien dhe nxënien ia përshtatë situatës dhe kontekstit.16. Mësimdhënien dhe nxënien i përshtatë me procesin e prodhimit ose shërbimit tek punëdhënësi, te i cili realizohet trajnimi praktik i nxënësit⁷.17. Te nxënësit ndërton standarde të larta personale për sukses, qëndrim pozitiv ndaj mësimin dhe jashtë mësimin dhe zhvillon shkathtësi për nxënie të përjetshme.18. Planifikon dhe realizon aktivitete plotësuese me të cilat forcohet dhe zgjerohet njohuria e përvetësuar (detyrë shtëpie, vizita, ekskursione, bashkëpunim, projekte, etj.).

7 Këto kompetenca kanë të bëjnë vetëm me arsimtarët e mësimin praktik dhe lëndëve profesionale-teorike në shkollat e mesme profesionale.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE


- Njofton nxënësit me rezultatet e pritura.
- Përcakton njohuritë dhe përvojat e mëparshme të nxënësve.
- U jep udhëzime të qarta të gjithë nxënësve⁸ dhe i udhëzon në transferimin e njohurive.
- Përgatitë nxënësit për realizimin dhe evidentimin e rezultateve nga trajnimi praktik të punëdhënësit⁹.
- Arsimtari ka përgatitur materiale për punë dhe mjete konkretizimi sipas asaj që është planifikuar dhe të njëjtat i zbaton.
- Në mënyrë të qartë, të kuptueshme dhe të vendosur i prezanton informacionet kryesore.
- Të gjithë nxënësit i përfshinë në realizimin e aktiviteteve.
- Zbaton qasje, forma dhe metoda të ndryshme dhe bashkëkohore.
- Është i gjindshëm në situata të reja dhe të paparashikueshme dhe i vendosë ato në kontekst të mësimi.
- Një pjesë të përmbajtjeve i realizon përmes aktiviteteve hulumtuese dhe projektuese.
- Zbaton TIK në mësimdhënie.
- Pranon dhe nxitë mënyra të ndryshme të zgjidhjes së problemeve dhe prezantimit të përmbajtjeve.
- Ndihmon nxënësit që të bëjnë sintezë të njohurive, t'i ndërlidhin njohuritë e mëparshme me ato të reja dhe ta shqyrtojnë zbatimin praktik të tyre.
- Përfshihet në planifikime dhe realizime të aktiviteteve të integruara ndërlëndore.
- Nxitë dhe orienton nxënësit drejt punës hulumtuese.
- Nxitë dhe udhëzon nxënësit për të ndjekur, analizuar dhe zbatuar informacionet për profesionet e ndryshme dhe për vazhdim të arsimit.

8 Me nocionin të gjithë nxënësit nënkuptohet nxënësit me nevoja të posaçme, si dhe nxënës me origjinë të ndryshme socio-ekonomike.

9 Këto kompetenca kanë të bëjnë vetëm me arsimtarët e mësimi praktik dhe lëndëve profesionale-teorike në shkollat e mesme profesionale.

II. MËSIMDHËNIE DHE NXËNIE

Nën-fusha: NOTIMI I NXËNËSVE

ARSIMTARI... 

A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
<p>7. E di se qëllimi primar i notimit është avancimi i të arriturave të nxënësve.</p> <p>8. Di metoda të ndryshme dhe bashkëkohore për vëzhgim dhe notim, si dhe mundësitë dhe kufizimet e atyre metodave.</p> <p>9. Njih standardet e parashikuara për arritje dhe për notim formativ dhe sumativ.</p>	<p>19. Ka pritje të larta për zhvillimin e nxënësve dhe për të arriturat e tyre.</p> <p>20. Në mënyrë sistematike e vëzhgon përparimin e nxënësve, i shënon njohuritë dhe u jep informacion cilësor kthyes¹⁰.</p> <p>21. Zgjedhë dhe zbaton strategji për notim që janë përkatëse me qëllimet.</p> <p>22. Përfshinë nxënësit në notim (vlerësim) dhe krijon klimë pozitive që nxënësit të mund t'i tregojnë të arriturat e tyre.</p> <p>23. Formon nota të bazuara dhe objektive sumative, i prezanton dhe arsyeton.</p> <p>24. Analizon dhe interpreton të dhënat nga notimi dhe i shfrytëzon për planifikimin e nxënies së mëtejshme të nxënësve.</p> <p>25. Informon prindërit¹¹ për përparimin e fëmijës së tyre, në mënyrë të rregullt dhe cilësore.</p> <p>26. Të arriturat e qëllimeve arsimore tek nxënësit i matë përmes notimit formativ dhe sumativ.</p> <p>27. Notimin diagnostik dhe formativ e bën me kohë dhe në mënyrë përkatëse.</p> <p>28. Respekton standardet për notim në nivel të shtetit.</p> <p>29. Gjatë realizimit të trajnimit praktik tek punëdhënësi, analizon dhe merr parasysh rezultatet nga vëzhgimi dhe notimi i nxënësit të realizuara nga kuadri profesional dhe kuadri tjetër¹².</p>

10 Të rregullt, të qartë dhe me kohë.

11 Me prind nënkuptohet edhe përfaqësuesi ligjor, kujdestar.

12 Këto kompetenca kanë të bëjnë vetëm me arsimtarët e mësimin praktik dhe lëndëve profesionale-teorike në shkollat e mesme profesionale.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Zgjedhë, përpunon dhe në mënyrë përkatëse shfrytëzon instrumente të ndryshme për vlerësim (p.sh. detyra, teste, lista kontrolluese, lista analitike, shënime anekdotike).
- Ka përmbledhje të dëshmime mirë të organizuara për përparimin e secilit nxënës që i shfrytëzon për informimin e nxënësve dhe prindërve, për përparimin e nxënësit dhe për planifikimin e nxënies dhe mësimdhënies.
- Diagnostikon njohuritë paraprake dhe anët e dobëta dhe të fuqishme në nxënien e nxënësve dhe u jep drejtime përkatëse për nxënien e mëtejshme.
- Ofron informacion kthyes pozitiv dhe konstruktiv që i nxitë nxënësit të punojnë dhe te ata zhvillon ndjenjën se mund të përparojnë.
- Bisedon me nxënësit për përparimin e tyre, i aftëson për vetëvlerësim dhe planifikim të nxënies personale.
- Gjatë notimit sumativ dhe formativ niset nga qëllimet e lëndës mësimore dhe notat i formon në bazë të matjeve të shumëfishta me metoda dhe instrumente përkatëse.
- Respekton standardet për notim në nivel të shtetit dhe rregullisht i evidenton të arriturat e nxënësve.
- I arsyeton notat dhe përpilon raporte të qarta dhe informative për të arriturat e nxënësve që ua dorëzon prindërve.
- Përpilon raporte për të arriturat në nivel të klasës /lëndës mësimore dhe njohuritë i shfrytëzon për përmirësimin e mësimdhënies dhe nxënies.
- Në notë i përfshin rezultatet e vëzhgimit dhe notimit të nxënësit nga ana e kuadrit profesional dhe kuadrit tjetër i cili merr pjesë gjatë realizimit të trajnimit praktik tek punëdhënësi¹³.

13 Këto kompetenca kanë të bëjnë vetëm me arsimtarët e mësimin praktik dhe lëndëve profesionale-teorike në shkollat e mesme profesionale.

II. MËSIMDHËNIE DHE NXËNIE

Nën-fusha: NJOHJE E NXËNËSVE DHE DALJE
NË NDIHMË NEVOJAVE TË TYRE

ARSIMTARI... 


A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
<ol style="list-style-type: none">10. I di karakteristikat zhvillimore të nxënësve.11. Njih dallimet, interesat dhe përvojat paraprake individuale të nxënësve.12. I di tendencat aktuale të jetesës dhe nevojat e të rinjve.13. Kupton nevojën për këshillim në karrierë të të rinjve.14. Është në rrjedha me njohuritë e reja shkencore për nxënien dhe zhvillimin e nxënësve.	<ol style="list-style-type: none">30. Njih nxënësit dhe kushtet në të cilat ata jetojnë dhe vepron në mënyrë të besueshme me të dhënat të cilat i ka në dispozicion.31. Identifikon anët e dobëta dhe të forta të secilit nxënës dhe e zhvillon potencialin e tij.32. Parashikon mënyra të mundshme të reagimit të nxënësit dhe në mënyrë përkatëse përballet me to.33. Mënyrat e punës i përshtatë me karakteristikat zhvillimore dhe stilet dhe strategjitë e nxënies së nxënësve.34. Kujdeset për zhvillimin e përgjithshëm të nxënësit, duke përfshirë edhe zhvillimin e tij në karrierë.35. Udhëheqë nxënësit nëpër procesin e nxënies, kontribuon për sjelljen pozitive.36. Motivon nxënësit për shfrytëzimin aktiv të kohës së lirë.37. Dëgjon dhe respekton qëndrimet, mendimet dhe interesat e nxënësve.38. Ndhmon nxënësit që të bëhen të vetëdijshëm për procesin e nxënies personale dhe aftëson nxënësit për nxënie dhe studim të mëvetësishëm.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- E ndjekë zhvillimin kognitiv, socio-emocional dhe psiko-motorik të nxënësve të tij.
- Ka të dhëna për secilin nxënës dhe i evidenton të gjitha ndryshimet.
- I ruan në vend të sigurt të dhënat për nxënësit e tij dhe lidhur me to shkëmben informacione vetëm me prindërit e nxënësit ose me bashkëpunëtorët profesionalë në shkollë.
- Bën individualizimin dhe diferencimin në mësimdhënie të mbështetur në njohjen e nevojave të nxënësve.
- Organizon dhe realizon mësim plotësues dhe shtues.
- Nxitë, përgatitë dhe organizon nxënësit që të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme (gara, konkurse, ekspozita, manifestime, aktivitete të projektit, etj.).
- Shfrytëzon aktivitete edukative që e nxisin zhvillimin kognitiv, afektiv dhe psiko-motorik të nxënësve.
- Mundëson participim demokratik të nxënësve në jetën e shkollës.



||| KRIJIM I MJEDISIT STIMULUES PËR NXËNIE

Mjedisi në të cilin fëmija qëndron dhe mëson ka ndikim të fuqishëm në zhvillimin e tij të përgjithshëm. Arsimtari është ai që duhet të kujdeset që mjedisi në të cilin qëndrojnë nxënësit e tij të jetë i sigurt. Prandaj duhet t'i dijë kërcënimet e mundshme ndaj sigurisë fizike dhe psikike të nxënësve, mënyrat në të cilat duhet të reagojë për të mundësuar mjedis të sigurt, si dhe rregullat që duhet t'i vendosë bashkë me nxënësit e tij me qëllim që në mënyrë të sigurt të shfrytëzohen mjetet dhe materialet për mësim, duke përfshirë edhe TIK-un. Në këtë mënyrë, krahas faktit që nxënësit janë të mbrojtur, te ata nxitet mëvetësia përmes asaj që ata mësojnë se si të mbrohen edhe vetë, si të sillen në mënyrë të përgjegjshme ndaj materialeve për punë, si të miratojnë rregulla të sjelljes dhe si t'i respektojnë të njëjtat. Mjedisi stimulues sigurohet nëse arsimtari i di mundësitë potenciale të mjeteve të ndryshme për nxënie, mundëson kapshmërinë e tyre dhe i shfrytëzon për t'i stimuluar nxënësit që të studiojnë dhe të mësojnë, me këtë rast krijon atmosferë në të cilën komunikohet me respekt, bashkëpunohet dhe punohet në mënyrë ekipore, në mënyrë të padhunueshme zgjidhen konfliktet, respektohet diversiteti, qëndrimet dhe mendimet e të gjithëve dhe nxitet sjellja pozitive dhe e përgjegjshme.

III. KRIJIM I MJEDISIT STIMULUES PËR NXËNIE

Nën-fusha: KRIJIM I MJEDISIT TË SIGURT DHE STIMULUES PËR NXËNIE



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHËSI PROFESIONALE
<ol style="list-style-type: none">1. Kupton se në çfarë mënyre mjedisi e nxitë dhe mundëson nxënien.2. I di potencialet dhe mundësitë e mjeteve të ndryshme për nxënie duke përfshirë TIK-un.3. Njeh veprimtarinë, organizimin, teknologjinë dhe pajisjen e punëdhënësit¹⁴.4. Njeh masat për siguri dhe mbrojtje gjatë punës¹⁴.5. Di për kërcënimet e mundshme ndaj sigurisë fizike dhe psikike të nxënësve.6. Njeh mënyra të ndryshme për përballje me situata të krizës në shkollë.7. Di mekanizma për t'u përballur me raste të dhunës dhe diskriminimit në çfarëdo baze.	<ol style="list-style-type: none">1. Organizon mjedis stimulues për nxënie (p.sh. inkurajon mendim të ndryshëm, ka raport pozitiv ndaj gabimeve, etj.).2. Organizon hapësirën për nxënie në pajtim me llojin e aktiviteteve dhe interesave të nxënësve.3. Siguron shfrytëzim të burimeve, materialeve dhe mjeteve të ndryshme në procesin e nxënies, duke përfshirë edhe shfrytëzimin e sigurt të TIK-ut.4. Identifikon makina, aparate dhe instrumente përkatëse për trajnim praktik të nxënësve dhe siguron shfrytëzimin e tyre përkatës dhe të sigurt¹⁴.5. Nxënësve u ofron ndihmë gjatë adaptimit në mjedisin shkollor, adekuat me moshën e tyre.6. Bashkë me nxënësit e tij merr pjesë në aktivitete të ndryshme shkollore dhe jashtëshkollore.7. Shfrytëzon strategji përkatëse për intervenim gjatë krizës në shkollë.8. Shfrytëzon mënyra përkatëse për t'u përballur me dhunë dhe diskriminim.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Hapësira është organizuar sipas normativit për hapësirë dhe pajisje.
- Përpilon materiale dhe shfrytëzon burime të ndryshme për nxënie që i stimulojnë nxënësit që të hulumtojnë dhe mësojnë.
- Përshtatë hapësirën në shkollë që t'u përputhet nevojave individuale dhe nevojave të gjithë grupit.
- Vendosë rregulla për përdorim të sigurt të materialeve dhe mjeteve për punë, duke përfshirë edhe TIK-un.
- Mundëson që mjetet dhe materialet për punë të jenë lehtë të arritshme për të gjithë nxënësit, veçanërisht për fëmijët me pengesa.
- Përgatitë nxënësit për sjellje të sigurt në vendin e punës në të cilin trajnohet, në pajtim me standardet për siguri dhe mbrojtje gjatë punës¹⁴.
- I sistemon nxënësit në vende përkatëse të punës, në pajtim me qëllimet e trajnimit praktik¹⁴.
- Në hapësirën e shkollës ekspozon punime nga nxënësit.
- Mundëson që të vendosen dhe sigurohet që të respektohen rregullat e sjelljes në klasë dhe shkollë.
- Siguron që nxënësit t'i respektojnë rregullat e komunikimit tek punëdhënësi¹⁴.
- Promovon vlera që kanë të bëjnë me sigurinë personale dhe sigurinë e tjerëve.

¹⁴ Këto kompetenca kanë të bëjnë vetëm me arsimtarët e mësimin praktik dhe lëndëve profesionale-teorike në shkollat e mesme profesionale.

III. KRIJIM I MJEDISIT STIMULUES PËR NXËNIE

Nën-fusha: KRIJIM I KLIMËS POZITIVE SHKOLLORE



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
8. Njeh karakteristikat dhe mënyrat për krijimin e klimës pozitive për nxënie.	9. Krijon klimë pozitive në klasë në pajtim me nevojat e të gjithë nxënësve.
9. Njeh strategji për menaxhim në klasë.	10. Respekton personalitetin e nxënësit, e nxitë dhe zhvillon vetëbesimin dhe vetërespektin te nxënësit.
10. Kupton se komunikimi është mjet i fuqishëm gjatë nxënies.	11. Bashkë me nxënësit vendosë rregulla të sjelljes në klasë dhe shërben si model për respektin e tyre.
11. Posedon njohuri për teknika dhe stile të komunikimit.	12. Shfrytëzon shkathtësi për zgjidhjen e konflikteve dhe këto shkathtësi i zhvillon tek nxënësit.
12. Njeh rregullat e komunikimit tek punëdhënësi ¹⁵ .	13. Krijon kushte që nxisin ndjenjën për përkatësi, respekt të ndërsjellë dhe kontribut ndaj bashkësisë shkollore.
13. Kupton se klima në paralele/klasë më së shumti varet nga arsimtari.	14. Nxitë dhe mbështetë punën ekipore tek nxënësit.
14. Është model për sjellje etike dhe ndershmëri.	15. Shfrytëzon teknikë ose stil përkatës të komunikimit varësisht nga nxënësit dhe situata.
	16. Shfrytëzon strategji komunikuese për respektimin e dallimeve kulturore dhe gjinore që mund të ndikojnë në klimën në klasë.
	17. Komunikimin me nxënësit e mbështetë në respekt dhe kujdes, duke i promovuar vlerat, qëndrimet dhe sjelljet pozitive që i pret nga nxënësit e vetë.
	18. Shfrytëzon mjete bashkëkohore për komunikim (e-postë, rrjete sociale, blogje, etj.).



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Nxënësve u drejtohet me emër dhe me respekt.
- Tregon ndjeshmëri dhe mbështetje të vlerave tek nxënësit.
- Inkurajon nxënësit të marrin pjesë në aktivitete, t'i shkëmbejnë përvojat, pritjet dhe emocionet e tyre dhe të besojnë se mund të arrijnë më shumë.
- Në klasë thekson rregullat e sjelljes dhe insiston në respektimin e tyre.
- Identifikon situata konflikti (të hapura dhe të fshehura).
- U ndihmon nxënësve që në mënyrë të drejtë t'i zgjidhin konfliktet.
- Organizon nxënësit në aktivitete të përbashkëta ku në shprehje vjen bashkëpunimi midis moshatarëve.
- Shfrytëzon këshillat e bashkëpunëtorëve profesionalë (psikolog, pedagog, sociolog, defektolog) gjithmonë kur duhet t'i ndihmohet ndonjë nxënësi.
- Gjatë komunikimit e përshtatë mënyrën e të shprehurit varësisht nga konteksti, situata dhe personaliteti i nxënësit.
- Parashtron pyetje, i nxitë nxënësit që të parashtrojnë pyetje dhe stimulon diskutim.
- Nxitë biseda për kuptimin e dallimeve kulturologjike dhe gjinore.
- Planifikon dhe përdorë media dhe instrumente të ndryshme për komunikim, duke përfshirë edhe mjetet ndihmëse audio-vizuale dhe kompjuterë.
- Nxitë (dhe prezanton) te nxënësit modele përkatëse të shprehurit gojor, me shkrim dhe në media të ndryshme.

15 Këto kompetenca kanë të bëjnë vetëm me arsimtarët e mësimit praktik dhe lëndëve profesionale-teorike në shkollat e mesme profesionale.




IV. INKLUZION (PËRFSHIRJE) SOCIAL DHE ARSIMOR

Nevoja që secili arsimtar të posedojë kompetenca për inkluzion (përfshirje) social dhe arsimor rezulton nga përcaktimi i shoqërisë që të sigurohen mundësi të barabarta për të gjithë nxënësit. Ato kanë të bëjnë me aftësinë, shkathtësitë dhe qëndrimet e arsimtarëve për punë në një mjedis që përbëhet prej diversiteteve. Me këtë rast, theksi është vendosur në nevojën për njohuri të arsimtarëve në raport me zgjidhjet dhe praktikën didaktike-metodike, zgjidhjet ligjore dhe konventat, potencialet dhe kufizimet e individëve dhe grupeve në nxënie dhe zhvillim. Veçanërisht të rëndësishme janë aftësia dhe shkathtësitë e arsimtarëve për t'i identifikuar nevojat, interesat, mundësitë dhe aftësitë specifike të nxënësve, për të planifikuar përfshirje dhe punë me të gjithë nxënësit duke i marrë parasysh nevojat dhe mundësitë e ndryshme, të zbatojnë strategji përkatëse për inkluzion (përfshirje) të nxënësve me nevoja të posaçme arsimore dhe të promovojnë respektim të ndërsjellë dhe vlera demokratike në shoqëri.

IV. INKLUZION (PËRFSHIRJE) SOCIAL DHE ARSIMOR

Nën-fusha: INKLUZION (PËRFSHIRJE) SOCIAL DHE ARSIMOR



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHËSI PROFESIONALE
<ol style="list-style-type: none">1. Njeh koncepte dhe modele të ndryshme për arsim inkluziv.2. I kupton faktorët socialë dhe kulturor dhe mënyrën se si ato ndikojnë në arsimin dhe kupton si arsimi kontribuon për kohezionin social.3. I di llojet e ndryshme të nxënësve të cilëve u nevojitet mbështetje plotësuese në arsim: nxënës me nevoja të posaçme arsimore, me vështirësi në nxënie dhe me mangësi të natyrës socio-ekonomike.4. I di konventat për të drejtat e fëmijëve dhe kundër diskriminimit.	<ol style="list-style-type: none">1. Merr pjesë në procesin e identifikimit të nevojave specifike arsimore bashkë me bashkëpunëtorët profesional dhe shfrytëzon metoda të ndryshme për diferencim dhe individualizim të mësimdhënies.2. Merr pjesë në ekipe për përpilimin e planeve individuale arsimore.3. Shfrytëzon strategji që promovojnë respektimin e dallimeve dhe vlerave demokratike.4. Punon në ekipet inkluzive shkollore.5. Ofron mundësi të barabarta që çdo fëmijë dhe familje të merr pjesë në aktivitetet mësimore dhe jashtëmësimore, pa dallim të aftësive psiko-fizike, gjinisë, prejardhjes etnike, kulturës, gjuhës amtare, religjionit, strukturës familjare, statusit social dhe ekonomik.6. Përgatitë nxënësit që t'i pranojnë fëmijët nga grupet e rrezikuara dhe fëmijët me nevoja të posaçme arsimore.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Përpunon plane individuale arsimore.
- Planifikon mësimin për gjithë klasën duke respektuar dallimet individuale midis nxënësve.
- Gjatë mësimdhënies shfrytëzon strategji inkluzive për nxënie dhe mësimdhënie.
- I ndjekë dhe vlerëson të arriturat dhe zhvillimin e nxënësit në pajtim me qëllimet individuale.
- Përfshihet në aktivitetet inkluzive në shkollë.
- Përpilon plan për punë dhe bashkëpunon me familjet e fëmijëve të cilëve u nevojitet mbështetje plotësuese në arsimim¹⁶.
- Bashkë me nxënësit përpunon mjete mësimore për punë inkluzive.
- Adaption klasën sipas nevojave individuale të nxënësve.
- Përfshinë familjet dhe nxënësit në aktivitete të përbashkëta për respektimin e dallimeve dhe integritet ndërkulturor.
- Merr pjesë në orientimin profesional të nxënësve me nevoja të posaçme arsimore.
- Bashkëpunon në mënyrë të vazhdueshme me bashkëpunëtorët profesional në shkollë për tejkalimin e arsyeve për përjashtim.
- Realizon mësim shtues dhe plotësues.
- Punon në mënyrë individuale me nxënës të cilëve u nevojitet ndihmë.

¹⁶ Me nxënës të cilëve u nevojitet mbështetje plotësuese në arsimin nënkuptohen nevojat që rezultojnë nga dallimet në aftësitë psiko-fizike, prejardhje etnike, kultura, gjuha amtare, religjioni, statusi social ekonomik.


V. KOMUNIKIM DHE BASHKËPUNIM ME FAMILJEN DHE BASHKËSINË

Shkathtësitë komunikuese janë jashtëzakonisht të rëndësishme për çdo mësim efektiv. Arsimtari duhet të ketë shkathtësi verbale dhe jo verbale komunikuese, duke përfshirë artikullimin, gjuhën ekspresive, tonin e fjalimit, qëndrimin përkatës dhe gjestikulimin.

Qartësia në prezantimet, informacionet kthyesë, dhënia e drejtimeve për nxënie dhe shfrytëzimi i mediave përkatëse komunikuese, kontribuon në krijimin e klimës efektive dhe efikase për nxënie. Shkathtësi veçanërisht e rëndësishme e arsimtarit është që të dijë të tregojë ndjeshmëri në komunikim që i jep mundësi për të ndërtuar klimën e besimit dhe bashkëpunimit me nxënësit dhe familjet e tyre. Prindërve duhet t'u sigurojë informacione të qarta, me kohë dhe të dobishme që do t'i orientojnë drejt mbështetjes së nxënies së fëmijëve të tyre dhe t'i motivojë për përfshirje në aktivitetet shkollore. Arsimtari, po ashtu, duhet të dijë dhe t'i shfrytëzojë mënyrat e ndryshme të komunikimit formal me bashkësinë profesionale dhe shoqërore.

V. KOMUNIKIM DHE BASHKËPUNIM ME FAMILJEN DHE BASHKËSINË

Nën-fusha: BASHKËPUNIM ME FAMILJET E NXËNËSVE
DHE BASHKËSINË LOKALE

ARSIMTARI... 

A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHËSI PROFESIONALE
<ol style="list-style-type: none">1. Kupton rëndësinë e familjes dhe bashkësisë lokale në jetën dhe punën e shkollës.2. Di mënyra për bashkëpunim me familjen dhe bashkësinë lokale dhe njih mundësi për pjesëmarrjen e tyre në jetën e shkollës.3. Njih rrethin e punës në të cilin nxënësit arsimohen në profesion¹⁷.4. Posedon njohuri dhe shkathtësi komunikuese.	<ol style="list-style-type: none">1. Promovon besim dhe mirëkuptim që të ndërtoj partneritete me bashkësinë lokale dhe familjet.2. Zhvillon bashkëpunim efektiv me familjet dhe anëtarët e bashkësisë gjatë realizimit të punës në shkollë.3. Komunikon me familjet në mënyrë përkatëse me respekt dhe vëmendje.4. Komunikon me mjedisin lokal, partnerët socialë dhe institucione tjera relevante në shtet dhe jashtë shtetit¹⁷.5. Bashkëpunon me punëdhënës për realizimin e trajnimit praktik¹⁷.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Përfshinë familjet në planifikimin e aktiviteteve të paraleles/klasës dhe shkollës.
- Përfshin familjet dhe përfaqësuesit e bashkësisë lokale në procesin e mësimdhënies.
- Përpilon kalendar individual të mbledhjeve me prindër (planifikon mbledhje prindërore, takime individuale, ditë të pranimit).
- Identifikon resurset e mundshme për bashkëpunim me bashkësinë.
- Bashkëpunon me institucione dhe individë nga bashkësia lokale.
- Ndërlidhë shkollën dhe punëdhënësit për shkak të organizimit dhe realizimit të llojeve të ndryshme të trajnimeve¹⁷.
- Përpilon dhe propozon marrëveshje/kontrata për realizimin e trajnimit praktik tek punëdhënës¹⁷;
- Merr pjesë në projekte të përbashkëta me punëdhënësit¹⁷.
- Merr pjesë dhe nxitë edukimin e prindërve.

¹⁷ Këto kompetenca kanë të bëjnë vetëm me arsimtarët e mësimit praktik dhe lëndëve profesionale-teorike në shkollat e mesme profesionale.

VI. ZHVILLIM PROFESIONAL DHE BASHKËPUNIM PROFESIONAL

Arsimtari kompetent është vazhdimisht në rrjedhë me risitë në profesionin e arsimtarit, di ta analizojë punën personale dhe t'i shpalosë anët e dobëta dhe në bazë të kësaj ta planifikojë zhvillimin e tij profesional. Njeh dhe i shfrytëzon format e ndryshme të përsosjes profesionale, me ç'rast edhe vetë ndërmerr iniciativa për përfshirje në to. Po ashtu, është i hapur për bashkëpunim me kolegët në dhe jashtë shkollës, mëson prej tyre dhe i shkëmben njohuritë e veta. Arsimtari që kujdeset për profesionin e vet e njeh dhe e respekton kodeksin e profesionit dhe kontribuon për përparimin e mjedisit në të cilin punon dhe renomesë së profesionit të arsimtarëve në shoqëri.

VI. ZHVILLIM PROFESIONAL DHE BASHKËPUNIM PROFESIONAL

Nën-fusha: ZHVILLIM PROFESIONAL

ARSIMTARI...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
<ol style="list-style-type: none">1. Kupton ndërlkueshmërinë e profesionit të arsimtarit, si dhe përgjegjësinë që sjellë profesioni.2. Njeh kompetencat për arsimtarë.3. I di modelet dhe mundësitë efektive për zhvillim profesional dhe përparim në profesionin e arsimtarit.4. Është i informuar për ngjarjet profesionale në arsim.5. Plotëson dhe sendërton njohuritë dhe shkathtësitë me anë të edukimit të vazhdueshëm.6. Di si të përpilojë plan personal për zhvillim profesional dhe të zhvillojë filozofi personale për profesionin.	<ol style="list-style-type: none">1. Vazhdimisht e përsosë praktikën personale pedagogjike në bazë të ndjekjes së ndryshimeve dhe risive në sistemin e arsimit, në bazë të reflektimit dhe vetëvlerësimit.2. Përparon punën e tij duke shfrytëzuar njohuri të përvetësuara përmes zhvillimit profesional (formal, joformal dhe informal).3. Identifikon nevojat personale arsimore dhe planifikon zhvillimin e tij personal.4. Zhvillon dhe zbaton shkathtësitë refleksive për analizimin dhe përmirësimin e praktikës personale.5. Përparon njohuritë dhe shkathtësitë profesionale përmes trajnimit të drejtpërdrejt tek punëdhënësi¹⁸.6. Nxitë dhe realizon studim dhe nxënie të përbashkët për përmirësimin e praktikave mësimore.7. Përcjellë literaturën profesionale nga lënda mësimore dhe literaturë tjetër pedagogjike-psikologjike.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Zbaton ndryshimet dhe risitë në sistemin e arsimit.
- Merr pjesë në dialog profesional dhe në mënyrë permanente përsoset në favor të zhvillimit personal dhe profesional.
- Mendon, vlerëson, kërkon informacione kthyes (nga kolegët, prindërit, nxënësit) dhe mban shënime për punën e tij pedagogjike.
- Planifikon, mban evidencë dhe posedon dëshmi për zhvillimin personal profesional.
- Merr pjesë në forma të ndryshme të përsosjes profesionale në dhe jashtë shkollës.
- Realizon hulumtime vepruese për përmirësimin e praktikës profesionale.
- Posedon plan personal për zhvillim profesional dhe të njëjtin e realizon.
- Zbaton njohuritë dhe shkathtësitë e përvetësuara nga trajnimet e vizituara.
- Bën vlerësimin e efekteve nga trajnimet¹⁸.

¹⁸ Këto kompetenca kanë të bëjnë vetëm me arsimtarët e mësimit praktik dhe lëndëve profesionale-teorike në shkollat e mesme profesionale.

VI. HVILLIM PROFESIONAL DHE BASHKËPUNIM PROFESIONAL

Nën-fusha: BASHKËPUNIM PROFESIONAL

ARSIMTARI...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
<p>7. E di kodeksin për komunikim me kolegët dhe e kupton rëndësinë e bashkëpunimit me ta.</p> <p>8. Është i informuar për shoqatat profesionale të arsimtarëve.</p>	<p>8. Në mënyrë aktive promovon marrëdhënie kolegjiale dhe bashkëpunon me kolegët.</p> <p>9. Respekton etikën profesionale dhe sillet me përgjegjësi ndaj shoqatave dhe ndaj kolegëve.</p> <p>10. Është anëtar në shoqata profesionale të arsimtarëve.</p> <p>11. Bashkëpunon me bashkëpunëtorët profesional dhe persona në dhe jashtë shkollës.</p>



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Propozon tema për trajnim në shkollë dhe merr pjesë në to.
- Merr pjesë në punën e aktiveve profesionale.
- Realizon me kohë dhe me cilësi detyrat e punës.
- Merr pjesë në aktivitete të ndryshme të shoqatave profesionale, rrjeteve sociale dhe forumeve me qëllim që ta përmirësojë punën e tij.
- Shkëmben materiale mësimore me kolegët.
- Shkëmben përvoja dhe shfrytëzon këshilla për përmirësimin e punës së tij.
- Te arsimtarët nga shkolla dhe/ose shkolla tjera të mesme, transmeton përvojën nga pjesëmarrja në trajnime te punëdhënësi¹⁹.
- Shfrytëzon komunikimin elektronik për bashkëpunim profesional.
- Mban dhe ndjekë orë të hapura.

¹⁹ Këto kompetenca kanë të bëjnë vetëm me arsimtarët e mësimit praktik dhe lëndëve profesionale-teorike në shkollat e mesme profesionale.



**STANDARDE
PROFESIONALE**
për **ARSIMTAR – MENTOR**

PIKËNISJE PËR PËRPILIMIN E STANDARDEVE PËR ARSIMTAR – MENTOR

Gjatë përpilimit të *Standardeve profesionale për arsimtar – mentor*, nisej prej përcaktimeve vijuese:

Përsosje e standardeve në bazë të kompetencave themelore profesionale të arsimtarëve - Arsimtari mentor dallohet sipas asaj se gjatë punës disavjeçare mësimore i ka pasuruar dhe përsosur kompetencat themelore profesionale për arsimtar. Praktika mësimdhënëse e arsimtarit–mentor dallohet sipas cilësisë së lartë dhe sipas shumë indikatorëve, që paraqet një hap përpara në kompetencat e arritura profesionale. Prandaj kompetencat e përshkruara për arsimtar-mentor janë përsosje e kompetencave të arritura profesionale dhe duhet të shikohen si komplementare dhe të akumuluar me to.

Përkushtim ndaj nxënies së përgjithshme dhe zhvillimit të profesionit të arsimtarit - Arsimtari–mentor duhet të tregojë se është i përkushtuar në sendërtimin gjithëpërfshirës profesional dhe se kontribuon për zhvillimin profesional të kolegëve në shkollë. Ai është praktikues refleksiv që e studion praktikën e vet dhe vazhdimisht përsoset në mënyrë profesionale për punën edukativo-arsimore në klasë, por tregon edhe interes më të gjerë për risitë në profesionin dhe arsimin në përgjithësi.

Theks në kompetencat për angazhim profesional për përmirësimin e mësimin në nivel të shkollës - Standardet për arsimtar-mentor, krahas përsosjes së kompetencave profesionale për punë edukativo-arsimore me cilësi jashtëzakonisht të lartë në klasë, e vendosin theksin në kompetencat e arsimtarit – për përparimin e punës edukativo-arsimore në shkollë si tërësi. Arsimtari - mentor posedon njohuri, aftësi dhe shkathtësi për atë se si të rritet efektiviteti në shkollë në tërësi dhe është i përkushtuar në arritjen e qëllimeve të shkollës. Ai e nxitë nxënien dhe përparimin e kolegëve, inicion diskutime dhe aktivitete për mësim efektiv dhe përmirësim të rezultateve të nxënësve.

Respektim i kontekstit arsimor në Republikën e Maqedonisë - Standardet për arsimtar-mentor e promovojnë mendimin se arsimtarët e dalluar në shkolla duhet të jenë bartës të përfshirjes së inovacioneve në shkollë dhe në shkëmbimin e njohurive dhe përvojave të tyre me kolegët me më pak përvojë, përfshihen në ndërtimin e vizionit për zhvillimin e shkollës dhe programimin e realizimit të tij²⁰. Ato, po ashtu, i kanë parasysh njohuritë se në shkollë ekzistojnë arsimtarë të përkushtuar të cilët janë kompetentë dhe janë liderë në përfshirjen e inovacioneve në shkollë, i shkëmbejnë njohuritë dhe përvojat e tyre me kolegët me më pak përvojë, angazhohen si trajnues shkollorë për çështje të ndryshme profesionale dhe përfshihen në ndërtimin e vizionit për zhvillimin e shkollës dhe programimin e realizimit të tij.

²⁰ Thuajse 2/3 e shkollave konsiderojnë se arsimtarët që kanë tituj duhet të kenë edhe angazhime plotësuese në shkollat. Raport nga analiza e mendimeve të shkollave në përsosjen profesionale dhe përparimin në tituj të kuadrit edukativo-arsimor, QMEQ 2013 dhe Raport nga diskutimet në grupet e fokusit për përsosje profesionale dhe përparimi në tituj të kuadrit edukativo-arsimore, QMEQ 2013

NJOHURI PËR LËNDËN MËSIMORE DHE PËR SISTEMIN EDUKATIVO-ARSIMOR

Njohuritë teorike dhe praktike të arsimtarëve-mentorë për lëndën dhe disiplinat në të cilat i mësojnë nxënësit dhe njohuritë për vlerat dhe shtrirjen e sistemit edukativo-arsimor të Republikës së Maqedonisë duhet t'i tejkalojnë njohuritë dhe kompetencat e arsimtarëve tjerë.

Nga arsimtari-mentor pritet të posedojë njohuri dhe kuptime të thella për bazën përmbajtësore të lëndës, të dijë t'i vlerësojë në mënyrë kritike dokumentet e ndërlidhura me lëndën mësimore dhe fushat e përfaqësuara, këto njohuri t'i shkëmbejë dhe diskutojë me kolegët dhe bashkë me ta të avancojë mësimin nga lënda në gjithë shkollën, si dhe të iniciojë interes për çështje nga mësimi nga lënda përkatëse në bashkësinë më të gjerë profesionale. Arsimtari-mentor duhet të dijë dhe të shfrytëzojë mënyrat për realizimin e mësimdhënies sipas lëndës përkatëse që e bëjnë mësimin interesant dhe tërheqës për nxënësit dhe i motivon që ta mësojnë në mënyrë të thellë. Nga ai pritet të dijë të japë mësim për përmbajtje nga lënda që i tejkalojnë kornizat e programeve të rregullta.

Arsimtari-mentor duhet ta njohë kontekstin më të gjerë arsimor, ndryshimet aktuale në arsimin dhe të dijë që ato njohuri t'i shfrytëzojë për modernizimin e punës së shkollës.

I. NJOHURI PËR LËNDËN MËSIMORE DHE PËR SISTEMIN EDUKATIVO-ARSIMOR

Nën-fusha: NJOHURI PËR LËNDËN MËSIMORE
DHE PËR SISTEMIN EDUKATIVO-ARSIMOR

ARSIMTARI - MENTOR ...



KOMPETENCA

1. Posedon dijeni dhe njohuri të thella për fushën e lëndës.
2. Në mënyrë kritike vlerëson dokumentet e ndërlidhura me lëndën mësimore.
3. Ofron dhe shkëmben njohuri me kolegët e tij për çështje nga fusha e tij.
4. Zhvillon dhe zbaton politika arsimore në shkollë.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Është mentor i nxënësve në gara shtetërore dhe/ose ndërkombëtare.
- Është mentor i nxënësve në realizimin e projekteve të reja (inovative).
- Është ligjërues në shkolla për të talentuar, shkolla verore/dimërore, etj., me qëllim thellimin e njohurive nga lënda mësimore.
- Inicion nisma të arsyetuara në shkollë, për përmirësimin e mësimin nga lënda mësimore.
- Udhëheqë ekupe/grupe punuese për analizë të programeve nga lënda mësimore.
- Udhëheqë ekupe profesionale për përkufizimin e përmbajtjeve për profilet arsimore nga profesioni i caktuar, që e përbëjnë pjesën e hapur të programeve mësimore²¹.
- Publikon artikuj në revista profesionale/shkencore për fushën shkencore dhe për mësimin në fushën lëndore.
- Përpilon programe arsimore për aftësim të moshuarve për punë, në pajtim me nevojat e shprehura të tregut të punës²¹.
- Për kolegët përpilon materiale plotësuese profesionale nga fusha arsimore.
- Është ligjërues në seminare/punëtori në shkollë, për tema të ndërlidhura me reformat në arsimin.
- Është anëtar i ekupeve/grupeve punuese për përpilimin e veprimeve, procedurave, rregulloreve dhe programeve në nivel të shkollës.

²¹ Këto kompetenca kanë të bëjnë me arsimtarët që mbajnë mësim praktik dhe arsimtarët e lëndëve teorike-profesionale në shkollat e mesme profesionale.

1. MËSIMDHËNIE DHE NXËNIE

Kompetencat për mësimdhënie dhe nxënie janë bërthama e kompetencave të arsimtarëve. Ajo për çka do të mbahet mend arsimtari i mirë është mënyra në të cilën e realizon mësimin. Arsimtari – mentor në këtë pikëpamje është “më i miri prej më të mirëve”. Ai njihet nga arsimtarët tjerë edhe nga nxënësit si mësimdhënës që shquhet në realizimin e mësimin dhe gjithashtu në përdorimin e qasjeve të reja që e bëjnë lëndën interesante për nxënësit dhe për këtë arsye numri më i madh i nxënësve e duan lëndën mësimore. Te nxënësit ai zhvillon interesin për zgjerimin e njohurive nga fusha e lëndës, e mbështetë angazhimin e tyre jashtëmësimor dhe i ndihmon dhe mundëson që të arrijnë rezultate të larta jo vetëm në kuadër të shkollës, por edhe më gjerë – në konkurse, gara, paraqitje publike, etj.

Arsimtari –mentor është një nga liderët në përfshirjen e qasjeve të reja në mësimin. Me këtë rast ai i shfrytëzon njohuritë profesionale dhe shkencore dhe përvojën personale. Përpiqet që mësimin ta përmirësojë në bazë të dhënave për anët e tij të mira dhe të dobëta. Për këtë qëllim ai shfrytëzon të dhënat nga llojet e ndryshme të vlerësimeve eksterne, nga studimet për efektivitetin e qasjeve të veçanta në mësim që vetë ose me kolegët i realizon në shkollën, dhe të dhënat nga reflektimi mbi punën personale mësimore. Njohuritë e veta i shkëmben me kolegët dhe propozon se si të avancohet puna edukativo-arsimore në nivel të shkollës.

Arsimtari-mentor është i ndjeshëm për nevojat e ndryshme të nxënësve të tij, pa marrë parasysh nëse ato janë të natyrës kognitive ose socio-emocionale dhe di me kohë t’i identifikojë ato dhe të reagojë në mënyrë përkatëse. Ai tregon kujdes për nxënësit jo vetëm gjatë mësimin, por edhe gjatë qëndrimit të përgjithshëm në shkollë, ndërsa shpesh edhe jashtë saj. Për këtë qëllim ka vendosur marrëdhënie partnere me prindërit e nxënësve, kolegët që u ligjërojnë lëndë tjera dhe me personalitete dhe institucione tjera relevante të rëndësishme për jetën aktuale të nxënësve të tij. Vetë jep shembuj për komunikimin demokratik dhe i mbështetë nxënësit që të marrin pjesë në mënyrë demokratike në jetën e shkollës dhe në bashkësinë më të gjerë shoqërore, me çka kontribuon për ndërtimin e sistemi të vlerave të nxënësit.

II. MËSIMDHËNIE DHE NXËNIE

Nën-fusha: **PLANIFIKIM DHE PËRGATITJE E MËSIMDHËNIES**

ARSIMTARI - MENTOR ...



KOMPETENCA

1. I analizon planifikimet nga lënda mësimore në nivel të shkollës dhe propozon përmirësime.
2. Krijon politika zhvillimore të shkollës.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Zhvillon modele dhe jep sugjerime për përmirësimin e cilësisë së planifikimit.
- Është anëtar i ekipit për përpilimin e programit zhvillimor.
- Planifikon aktivitete vullnetare me persona kompetentë për përmirësimin e nxënies.
- Udhëheqë ekipin profesional që realizon projekte të përbashkëta mes shkollës dhe punëdhënësve²².
- Udhëheqë ekipin për vetëvlerësim sipas fushës, në shkollën.

II. MËSIMDHËNIE DHE NXËNIE

Nën-fusha: **REALIZIM I MËSIMDHËNIES**

ARSIMTARI - MENTOR ...



KOMPETENCA

3. Shfrytëzon metoda të reja efektive dhe qasje në mësimin dhe në aktivitetet jashtë mësimore.
4. Krijon dhe realizon projekte të reja (inovative) në nivel të shkollës.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Realizon orë të hapura mësimore dhe/ose shkëmben shembuj të incizuar të praktikës së mirë personale, dhe në to demonstron metoda të reja dhe efektive në mësim.
- Prezanton njohuri nga studimet e veprimit për përmirësimin e mësimin në shkollë.
- Udhëheqë ekipin profesional që realizon projekte të reja (inovative) në shkollë.
- Posedon çertifikata për zbatimin e njohurive/shkathtësive të përvetësuara nga projektet e realizuara në mësim.
- Është anëtar i ekipeve për certifikimin e zbatimit të qasjeve të reja (inovative) në mësim.

²² Këto kompetenca kanë të bëjnë me arsimtarët që mbajnë mësim praktik dhe arsimtarët e lëndëve teorike-profesionale në shkollat e mesme profesionale.

II. MËSIMDHËNIE DHE NXËNIE

Nën-fusha: **NOTIM I NXËNËSVE**

ARSIMTARI - MENTOR ...



KOMPETENCA

5. Shfrytëzon rezultatet dhe/ose përmbajtjet nga notimet eksterne (nacionale dhe ndërkombëtare) për përmirësimin e mësimdhënies.
6. Zhvillon kritere dhe instrumente për notim në nivel të shkollës.
7. Motivon dhe përgatitë nxënësit për arritjen e rezultateve të larta.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Bën analiza krahasuese të detyrave (përmbajtjeve, aftësive që maten) nga notimet eksterne nacionale dhe/ose ndërkombëtare me metodat mësimore dhe notimet që përdoren në shkollë.
- Është anëtar i ekipit për përgatitjen e kriterëve dhe instrumenteve për vlerësimin e nivelit të lëndës mësimore në shkollë.
- Është anëtar i ekipit për kontroll ekstern të arriturave të mësimdhënësve, për programet mësimore që vlerësohen përmes dosjes së nxënësit.
- Zhvillon instrumente për vlerësimin e nxënësve që janë të mentoruar nga ana e mentorëve tek punëdhënësi²³.
- Mentoron nxënës nga shkolla që fitojnë njërin nga tre vendet e para në gara rajonale, shtetërore dhe /ose ndërkombëtare.
- Arrin rezultate të larta me nxënësit të vërtetuar me testim objektiv intern dhe ekstern, krahasuar me të arriturat e nxënësve në shkolla tjera të ngjashme/të përafërta.

II. MËSIMDHËNIE DHE NXËNIE

Nën-fusha: **NJOHJE E NXËNËSVE DHE DALJE NË NDIHMË NEVOJAVE TË TYRE**

ARSIMTARI - MENTOR ...



KOMPETENCA

8. Shfrytëzon qasje të diferencuar në mësim dhe shkëmben përvojat me kolegët.




SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Zbaton forma të ndryshme të diferencimit në mësim.
- Bën analizë të efekteve që dalin nga shfrytëzimi i qasjes së diferencuar në mësimdhënien personale dhe njohuritë nga analiza i shkëmben me kolegët.

²³ Këto kompetenca kanë të bëjnë me arsimtarët që mbajnë mësim praktik dhe arsimtarët e lëndëve teorike-profesionale në shkollat e mesme profesionale.



II. KRIJIM I MJEDISIT STIMULUES PËR NXËNIE

Arsimtari – mentor ka vizion për atë se si duhet të jetë klasa (kabineti) që të jetë vend përkatës për nxënie të lëndës mësimore që e ligjëron. Për këtë qëllim ai punon në mënyrë afatgjate në sigurimin e mjeteve të nevojshme mësimore, prej të cilave një pjesë të madhe i ka përpunuar vetë ose me nxënësit e tij ose i ka siguruar përmes donacioneve. Ai me nxënësit dhe kolegët siguron dhe ruan materiale mësimore që mund të përdoren në mënyrë të shumëfishtë, me çka, gjatë një periudhe të gjatë kohore, ka siguruar mësimi në lëndën e tij të zhvillohet si në “laborator të vërtetë shkencor” ose në kabinet të artit. Në këtë drejtim, ai në mënyrë përkatëse e ka organizuar shfrytëzimin e TIK-ut në mësimdhënie, gjithmonë kur një gjë e tillë është mënyra më adekuate për realizimin e mësimi. Bën koleksion të përmbajtjeve digjitale nga lënda e tij, ndërsa edhe vetë zhvillon përmbajtje të tilla. Nxënësit i udhëzon për shfrytëzim të sigurt të mjeteve ndihmëse teknike, si dhe të mjeteve elektronike për komunikim dhe kujdeset që rregullat e vendosura të respektohen në mënyrë të vazhdueshme.

Arsimtari – mentor ka shkathtësi dhe përvojë për të kontribuar që gjithë shkolla të jetë mjedis i punës në të cilin mësohet dhe në të cilin të gjithë ndjehen mirë dhe të sigurt. Ai me të punësuarit tjerë punon në mënyrë ekipore për përmirësimin e komunikimit në shkollë, informimin e ndërsjellë për ngjarjet me rëndësi për nxënësit, të punësuarit, prindërit dhe bashkësinë më të gjerë. Ky arsimtar ka ide dhe inicion nisma për përmirësimin e klimës shkollore, parandalimin e dhunës dhe zgjidhjen e konflikteve jo vetëm gjatë mësimi, por edhe në jetën e përgjithshme në shkollë. Në këtë mënyrë ai kontribuon për sjellje vazhdimisht të përgjegjshme të të gjithëve.

III. KRIJIM I MJEDISIT STIMULUES PËR NXËNIE

Nën-fusha: KRIJIM I MJEDISIT TË SIGURT DHE STIMULUES PËR NXËNIE

ARSIMTARI - MENTOR ...



KOMPETENCA

1. Në mënyrë kreative shfrytëzon TIK-un në mësimin.
2. Krijon mjedis të pasur dhe stimulues për nxënie, përmes ofrimit të materialeve dhe mjeteve për nxënie.
3. Zhvillon strategji për krijimin e mjedisit të sigurt për nxënie.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Krijon dhe shfrytëzon përmbajtje digjitale për nxënie dhe i shkëmben me kolegët.
- Përpilon dhe posedon përmbledhje të pasura të materialeve mësimore dhe burimeve të nxënies që gjenden në dispozicion të nxënësve.
- Krijon vende të reja të punës për trajnim praktik të nxënësve në punëtoritë shkollore, në kompanitë shkollore dhe te punëdhënësit²⁴.
- Menaxhon me kompaninë shkollorë²⁴.
- Punon në ekipe për përmirësimin e sigurisë në shkollë.
- Krijon dhe zbaton aktivitete me nxënës dhe prindër për zvogëlimin e dhunës.
- Krijon masa për mjedis të sigurt gjatë trajnimit praktik të nxënësve²⁴.



III. KRIJIM I MJEDISIT STIMULUES PËR NXËNIE

Nën-fusha: KRIJIM I KLIMËS POZITIVE SHKOLLORE

ARSIMTARI - MENTOR ...



KOMPETENCA

4. Kontribuon në krijimin e klimës dhe komunikimit pozitiv shkollor.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Ngritë dhe mirëmban media të ndryshme për komunikim në shkollë dhe me rrethin (rrjete sociale, tabela të shpalljes, informatorë, broshura, gazetë shkollore, etj.).
- Ndërmerr aktivitete për parandalimin dhe tejkalimin e situatave të konfliktit.



²⁴ Këto kompetenca kanë të bëjnë me arsimtarët që mbajnë mësim praktik dhe arsimtarët e lëndëve teorike-profesionale në shkollat e mesme profesionale.

IV. INKLUZION (PËRFSHIRJE) SOCIAL DHE ARSIMOR

Arsimtari-mentor me sukses i përfshinë në aktivitetet mësimore dhe jashtëmësimore të gjithë nxënësit me të cilët punon duke i respektuar dallimet e tyre. Ai gjithashtu i shfrytëzon njohuritë, kuptimet dhe shkathtësitë e tij për arsim përfshirës (inkluziv) gjatë zhvillimit të qasjeve që kontribuojnë e gjithë shkolla të jetë inkluzive. Për këtë qëllim ai përfshihet në hulumtime dhe projekte, qëllimi i të cilave është përfshirja e grupeve të caktuara të ndjeshme në shkollë, si dhe në aktivitete të orientuara drejt përmirësimit të përfshirjes (inkulzivitetit) në tërë shkollën.

Krahas kësaj, arsimtari-mentor u ndihmon kolegëve me më pak eksperiencë në zhvillimin e programeve individuale arsimore, në përzgjedhje, përgatitje dhe vlerësim të materialeve të ndryshme për nxënie, të cilat janë të përshtatura me nevojat e posaçme të nxënësve të caktuar. Nga përvoja personale, me ta dhe me bashkësinë më të gjerë shkëmbehen shembuj të suksesshëm të punës inkluzive, i promovon mundësitë dhe të arriturat e nxënësve nga grupet e ndryshme të ndjeshme dhe në këtë mënyrë kontribuon për tejkalimin e stereotipave dhe paragjykimëve ndaj grupeve të caktuara të njerëzve dhe drejt respektimit të ndërsjellë të të gjithëve, si dhe drejt zhvillimit të vlerave demokratike në shoqëri.

IV. INKLUZION (PËRFSHIRJE) SOCIAL DHE ARSIMOR

Nën-fusha: INKLUZION (PËRFSHIRJE) SOCIAL DHE ARSIMOR

ARSIMTARI - MENTOR ... 

KOMPETENCA

1. Zhvillon qasje për ndërtimin e një shkolle gjithëpërfshirëse (inkluzive).



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Punon në projekte dhe hulumtime me fëmijë dhe për fëmijë me nevoja të posaçme arsimore, integrim ndëretnik dhe/ose inkluzion socio-ekonomik në kuadër të shkollës.
- Ndihmon kolegët në përpilimin e programeve individuale arsimore, materialeve dhe qasjeve.
- Është anëtar i ekipit për inkluzion shkollor në shkollën.
- Inicion nismë dhe ndërmerr aktivitete për dallim dhe respektim të diversitetit në nivel të shkollës dhe në bashkësinë më të gjerë.



V. KOMUNIKIM DHE BASHKËPUNIM ME FAMILJEN DHE BASHKËSINË

Arsimtari – mentor dallohet si arsimtar që ka shkathtësi shumë të mira komunikuese, si në mësim, ashtu edhe në komunikim me bashkësinë më të gjerë shoqërore. Përmbajtjet mësimore i prezanton qartë, e mban vëmendjen e nxënësve, reagon në mënyrë përkatëse verbale dhe jo verbale ndaj sjelljes së tyre. Në komunikimin ka ndërtuar klimë të besimit dhe respekt të ndërsjellë me nxënësit, kolegët, prindërit dhe anëtarët e bashkësisë më të gjerë shoqërore.

Arsimtari – mentor është veçanërisht i dalluar sipas shkathtësive për komunikim me familjet dhe bashkësinë më të gjerë shoqërore. Ai di mënyra se si bashkësinë shoqërore ta përfshijë në punën e shkollës dhe si ta përfshijë shkollën në aktivitete të bashkësisë më të gjerë shoqërore.

V. KOMUNIKIM DHE BASHKËPUNIM ME FAMILJEN DHE BASHKËSINË

Nën-fusha: BASHKËPUNIM ME FAMILJET E NXËNËSVE
DHE BASHKËSINË LOKALE

ARSIMTARI - MENTOR ...



KOMPETENCA

1. Përmirëson bashkëpunimin e shkollës me familjen dhe bashkësinë lokale.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Promovon shkollën përmes mediave dhe materialeve të ndryshme.
- Merr pjesë në ndërtimin e strategjive për bashkëpunim me familjen dhe bashkësinë lokale.
- Vendosë kontakte për bashkëpunim të shkollës me organizata për përmirësimin e nxënies dhe mirëqenies së nxënësve.
- I informon kolegët për qasjet e shkollës që kanë të bëjnë me realizimin e risive në sistemin arsimor dhe mënyrat e informimit të prindërve për to.
- Realizon aktivitete edukative për rolin e prindërve në nxënien dhe zhvillimin e fëmijës së tyre.
- Identifikon potencialet e familjeve dhe organizon përfshirjen e tyre në aktivitetet e shkollës.



VI. ZHVILLIM PROFESIONAL DHE BASHKËPUNIM PROFESIONAL

Arsimtari – mentor, më shumë se arsimtarët tjerë, i është përkushtuar zhvillimit personal dhe profesional të të gjithëve në shkollë. Vazhdimisht është në rrjedhë me risitë në mësim dhe më gjerë në arsim, i di mundësitë e ndryshme për zhvillim personal profesional dhe të kolegëve, si dhe i shkëmben me ta. Me vetiniciativë shfrytëzon forma të ndryshme të zhvillimit profesional dhe përfshihet në zhvillimin profesional jo vetëm për tema të lidhura ngushtë me mësimin, por edhe për problematikën më të gjerë arsimore. Njohuritë e sapo fituara i shkëmben në nivel të shkollës përmes trajnimeve formale dhe përmes diskutimeve joformale. Ka shkathtësi të mira për punë me të moshuar dhe prandaj shpesh luan rolin e trajnuesit në shkollë.

Në shkollë kontribuon për vlerësimin e mirë të nevojave për zhvillim profesional dhe planifikimin e tyre, kështu që të gjithë do të kenë përfitime nga ky proces. Veçanërisht promovon praktikë reflektuese, si përmes shembullit personal, ashtu edhe përmes përpilimit të instrumenteve dhe llojeve të ndryshme të ndihmës kolegjiale. Ai dallohet edhe nga arsimtarët tjerë si kolegë të cilit gjithmonë mund t'i drejtohesh për këshillë dhe ndihmë, si për shembull vizita në orë te kolegët ose hapje të klasës së vet për kolegët. Për shkak të profesionalizmit dhe besueshmërisë së lartë profesionale, përfshihet në ekipe për vlerësimin e punës së kolegëve që ata të marrin çertifikata, për promovimin ose identifikimin e nevojave për zhvillim profesional.

Merr pjesë në përpilimin e normave dhe materialeve për etikë të arsimtarëve në shkollë, i respekton dhe promovon ato, me çka kontribuon për renomenë e shkollës dhe të profesionit të arsimtarit.

VI. ZHVILLIM PROFESIONAL DHE BASHKËPUNIM PROFESIONAL

Nën-fusha: ZHVILLIM PROFESIONAL

ARSIMTARI - MENTOR ...



KOMPETENCA

1. Në mënyrë permanente përsoset në aspektin profesional, përmes pjesëmarrjes në forma të ndryshme të nxënies formale dhe joformale në funksion të procesit arsimor.
2. Zhvillon dhe zbaton strategji shkollore për zhvillim profesional.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Në formë të shkruar rishikon zhvillimin personal dhe praktikën personale profesionale.
- Përpilon instrumente për reflektim dhe vetëvlerësim.
- Merr pjesë në trajnimet e akredituara për shkathtësi mentoruese.
- Posedon çertifikata dhe/ose lloje tjera të dëshmimeve.
- Përpilon plan intern për këshillime, trajnime, orë të hapura.
- Është anëtar i ekipit shkollor për zhvillim profesional.



VI. ZHVILLIM PROFESIONAL DHE BASHKËPUNIM PROFESIONAL

Nën-fusha: BASHKËPUNIM PROFESIONAL

ARSIMTARI - MENTOR ...



KOMPETENCA

3. Kontribuon për zhvillimin profesional të kolegëve.
4. Promovon dhe praktikon modele për sjellje etike në të gjitha llojet e komunikimit profesional (me nxënësit, kolegët dhe bashkësinë më të gjerë).



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Me kolegët, shkëmben përvoja dhe shpërndanë njohuritë e fituara në seminare, konferenca, trajnime etj.
- I informon dhe nxitë kolegët për shfrytëzimin e mundësive për nxënie jashtë shkollës.
- Merr pjesë në komisione për zgjedhje dhe përparim të kuadrove.
- Organizon dhe realizon trajnime interne në shkollën.
- Udhëheqë me ekipet në shkollën që punojnë në avancimin e punës edukativo-arsimore të shkollës.
- Përpilon materiale për sjellje etike në shkollë.





STANDARDE
PROFESIONALE *për*
ARSIMTAR – KËSHILLTAR

PIKËNISJE PËR PËRPILIMIN E STANDARDEVE PËR ARSIMTAR - KËSHILLTAR

Gjatë përpilimit të *Standardeve profesionale për arsimtar-këshilltar* është nisur nga përcaktimet vijuese:

Avancim i standardeve të kompetencave themelore profesionale të arsimtarëve dhe standardeve profesionale për arsimtar-mentor. Arsimtari-këshilltar dallohet me atë që si arsimtar-mentor ka treguar se është lider në cilësinë e punës së drejtpërdrejtë me nxënësit, por edhe lider në avancimin e cilësisë së punës edukativo-arsimore në gjithë shkollën, në rajon, si dhe në avancimin dhe zhvillimin e arsimit në tërësi. Prandaj kompetencat e përshkruara për arsimtar-këshilltar janë shtuar në kompetencat e arritura profesionale për arsimtar-mentor dhe duhet të shihen si komplementare dhe të akumuluar me to.

Përkushtim ndaj mësimi të përjetshëm dhe zhvillimit në profesionin e arsimtarit. Arsimtari-këshilltar duhet të tregojë se është i përkushtuar ndaj zhvillimit personal profesional, kontribuon për zhvillimin profesional të kolegëve në shkollë, por edhe të zhvillimit profesional të kolegëve nga shkollat tjera. Ai është praktikues refleksiv që e studion punën e vet dhe vazhdimisht përsoset në aspektin profesional për avancimin e punës së drejtpërdrejtë edukativo-arsimtare në klasë dhe shkollë dhe për futjen e risive edhe më gjerë në arsim. Me angazhimin e vet profesional ai kontribuon për përparimin e profesionit të arsimtarit dhe për afirmimin e tij.

Theksi i kompetencave për angazhim profesional për përmirësimin e mësimit në rajon dhe në nivel nacional. Standardet për arsimtar–këshilltar, krahas përsosjes së kompetencave profesionale për punën edukativo-arsimore në klasë dhe në shkollë si tërësi, theksi vihet në kompetencat për përmirësimin e procesit edukativo-arsimor në rajon dhe në nivel kombëtarë. Arsimtari–këshilltar posedon njohuri dhe shkathtësi për ndërtim dhe udhëheqje të bashkësive profesionale për mësim në nivel rajonal ose nacional me qëllim që të përmirësohet mësimi në lëndën ose fushën përkatëse, por edhe të sistemin edukativo-arsimor në tërësi.

Respektim i kontekstit arsimor në Republikën e Maqedonisë. Standardet për arsimtar–këshilltar e promovojnë mendimin se arsimtarët e dalluar në shkollat duhet të angazhohen në përfshirjen e risive në procesin edukativo-arsimor, në shkëmbimin e njohurive dhe përvojave me kolegë, si dhe të përfshihen në ndërtimin e vizionit për zhvillimin e shkollës, programimin e realizimit të tij dhe në ndryshimet në arsimin dhe edukimin në nivel sistemor²⁵. Merreshin parasysh edhe njohuritë se në shkollat ekzistojnë arsimtarë të përkushtuar që janë kompetentë dhe janë liderë në përfshirjen e risive në shkollë, rajon ose në nivel kombëtarë, i shkëmbejnë njohuritë dhe përvojat e veta me kolegët, angazhohen si trajnues për çështje të ndryshme profesionale në nivel nacional dhe përfshihen në aktivitete të ndryshme për përparimin e arsimit.

²⁵ Thuajse 2/3 e shkollave konsiderojnë se arsimtarët që kanë tituj duhet të kenë edhe angazhime plotësuese në shkollat. Raport nga analiza e mendimeve të shkollave për përsosje profesionale dhe avancimin në tituj të kuadrit edukativo-arsimor, QMEQ 2013, dhe Raport nga diskutimet në grupet e fokusit për përsosje profesionale dhe avancim në tituj të kuadrit edukativo arsimor, QMEQ 2013,

NJOHURI PËR LËNDËN MËSIMORE DHE PËR SISTEMIN EDUKATIVO-ARSIMOR

Njohuritë teorike dhe praktike të arsimtarit-këshilltar për lëndën dhe disiplinat në të cilat i mëson nxënësit dhe njohuritë për vlerat dhe shtrirjen e sistemit edukativo-arsimor të Republikës së Maqedonisë, duhet t'i tejkalojnë njohuritë dhe kompetencat e arsimtarit-mentor.

Arsimtari-këshilltar posedon njohuri dhe kuptime të thella për lëndën mësimore, që e mundësojnë atë t'i vlerësojë dhe në mënyrë kritike t'i notojë dokumentet e ndërlydhura me lëndën mësimore dhe fushat e përafërta në nivel kombëtarë dhe të japë propozime të argumentuara për përmirësimin e tyre. Prej tij pritet të dijë t'i ndërlydhë njohuritë për lëndën mësimore, njohuritë metodike dhe përvojën praktike, ashtu që do t'i shndërrojë në materiale cilësore mësimore.

Në bashkëpunim me personin përgjegjës nga fakulteti, e ndjekë punën e studentit gjatë realizimit të mësimit praktik nga lënda përkatëse dhe ushtron vlerësim formativ dhe sumativ të punës së tij/saj²⁶.

Arsimtari-këshilltar i njeh situatat aktuale dhe ndryshimet që ndodhin në arsim, i përcjellë tendencat arsimore dhe di këto njohuri t'i shfrytëzojë për nisma dhe aktivitete për përmirësimin e sistemit edukativo-arsimor.

²⁶ Ndjekje e punës praktike të studentëve që janë arsimtarë të ardhshëm në mësimin klasor, si dhe evalvimi i punës së tyre do të bëhet sipas „Udhëzuesit për realizimin e mësimit praktik të studentëve nga fakultetet për mësimdhënës” - Shkup 2013 (i përgatitur nga: Universiteti „Shën Kirili dhe Metodi” – Shkup, Univeristet Shtetërorë i Tetovës, Universiteti „Shën Kliment Ohridski”-Manastir, Universiteti „Goce Delcev”- Shtip, në bashkëpunim me: Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe Byronë për Zhvillimin e Arsimit, me mbështetje të Misionit të OSCE në Shkup).

I. NJOHURI PËR LËNDËN MËSIMORE DHE PËR SISTEMIN EDUKATIVO-ARSIMOR

Nën-fusha: NJOHURI PËR LËNDËN MËSIMORE

ARSIMTAR - KËSHILLTAR...



KOMPETENCA

1. Përgatitë materiale mësimore dhe materiale për nxënie të recensuara pozitivisht.
2. Posedon njohuri dhe kuptim të thellë për fushën e lëndës.
3. I përcjellë, analizon dhe përmirëson dokumentet programore në nivel nacional.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Është autor i materialeve të recensuara dhe të publikuara mësimore, (p.sh. fletore pune, mjete mësimore dhe ndihmëse, doracakë, etj.) dhe i materialeve për nxënie.
- Merr pjesë në planifikimin dhe programimin e mësimit praktik të studentëve (që vijnë nga fakultetet) dhe i mentoron ata në bashkëpunim me mentorin – profesor nga lënda përkatëse.
- Është recensues i materialeve mësimore (libra, fletore pune, mjete mësimore dhe ndihmëse) që janë të aprovuara në nivel kombëtar.
- Është anëtar i ekipeve për hartimin e dokumenteve programore nga lënda mësimore.
- Është anëtar i ekipeve për përpilimin e dokumenteve konceptuese dhe programore nga fusha e arsimit dhe trajnimit profesional²⁷.
- Udhëheqë ekipe në nivel rajonal ose kombëtarë për analizë të dokumenteve programore nga lënda mësimore;
- Përpilon instrumente për vlerësimin e dokumenteve programore.
- Merr pjesë në analiza të tregut të punës dhe propozon zgjidhje për sigurimin e kuadrit profesional në pajtueshmëri me nevojat²⁷.

I. NJOHURI PËR LËNDËN MËSIMORE DHE PËR SISTEMIN EDUKATIVO-ARSIMOR

Nën-fusha: NJOHURI PËR SISTEMIN EDUKATIVO-ARSIMOR

ARSIMTAR - KËSHILLTAR...



KOMPETENCA

4. Analizon dhe përpilon dokumente konceptuese dhe strategjike në arsim.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Është anëtar i ekipeve për përgatitjen e dokumenteve konceptuese në arsim.
- Është autor/bashkautor i analizave dhe vlerësimeve të aspekteve të caktuara të sistemit arsimor në nivel kombëtar.
- Merr pjesë në grupet punuese për propozimin e ndryshimeve në evidencën dhe dokumentacionin pedagogjik.

²⁷ Këto kompetenca kanë të bëjnë me arsimtarët që mbajnë mësim praktik dhe arsimtarët e lëndëve teorike-profesionale në shkollat e mesme profesionale.

II. MËSIMDHËNIE DHE NXËNIE

Arsimtari-këshilltar dallohet si arsimtar cilësor jo vetëm në shkollën e tij, por edhe në bashkësinë më të gjerë profesionale. Ai është i njohur për përfshirjen dhe promovimin e risive në mësim, jo vetëm në shkollën në të cilën punon, por edhe në mesin e kolegëve nga shkollat tjera. Posedon njohuri për studime në fushën e arsimit që i shfrytëzon për përparimin e mësimin në shkollë dhe u ndihmon kolegëve në shkollë dhe në rajon që ta përparojnë praktikën në bazë të dëshmimeve për efektivitetin e qasjeve, metodave dhe teknikave të shfrytëzuara. Realizon projekte të reja duke u dhënë shembull pozitiv arsimtarëve tjerë për përfitimet nga të njëjtat. Vëmendje të posaçme u kushton të dhënave që janë marrë nga notimet interne dhe eksterne, të njëjtat di t'i analizojë dhe t'i shfrytëzojë për përmirësimin e mësimin personal, si dhe për ofrimin e sugjerimeve, si të përmirësohet mësimdhënia në shkollë.

Arsimtari-këshilltar është njëri nga ata arsimtarë që kujdesen për zhvillimin e gjithë shkollës. Është udhëheqës i ekipeve që i analizojnë situatat në shkollë dhe punojnë në planifikimin strategjik të zhvillimit të tij. Ai ofron shembull se si përmes punës së përgjithshme të kontribuohet për përmirësimin e mësimdhënies dhe nxënies. Vendosë standarde të larta për mësim cilësor dhe ndihmon kolegët që t'i arrijnë.

II. MËSIMDHËNIE DHE NXËNIE

Nën-fusha: PLANIFIKIM DHE PËRGATITJE E MËSIMDHËNIES

ARSIMTAR - KËSHILLTAR...



KOMPETENCA

1. Udhëheqë procesin e planifikimit zhvillimor të shkollës.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Bashkërendit aktivitetet për ndërlidhjen e planeve të përpiluara strategjike dhe zhvillimore.
- Organizon vëzhgimin dhe vlerësimin e realizimit të programit për zhvillimin e shkollës.
- Përgatitë raport nga evalvimi i programit për zhvillim në nën-fusha të caktuara.



II. MËSIMDHËNIE DHE NXËNIE

Nën-fusha: REALIZIMI I MËSIMDHËNIES

ARSIMTAR - KËSHILLTAR...



KOMPETENCA

2. Krijon, aplikon dhe zbaton projekte të reja (inovative) në bashkëpunim me institucione profesionale kombëtare dhe ndërkombëtare.
3. Promovon qasje moderne në mësim para komunitetit më të gjerë profesional.
4. Ndihmon kolegët në krijimin e shembujve të praktikës së mirë dhe realizimin e hulumtimeve aksionare.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Është anëtar i ekipit që udhëheqë projekte të reja (inovative) në nivel kombëtar.
- Publikon shembuj nga praktika personale mësimore në revista profesionale ose i poston në ueb faqe zyrtare (të recensuara).
- Mban trajnime në shkollë për hulumtime veprimi dhe kolegëve u jep këshilla gjatë zbatimit të tyre.
- Merr pjesë në ndërtimin e kriterëve për shembuj të praktikës së mirë dhe për vlerësimin e shembujve nga praktika e kolegëve.



II. MËSIMDHËNIE DHE NXËNIE

Nën-fusha: NOTIMI I NXËNËSVE

ARSIMTAR - KËSHILLTAR...



KOMPETENCA

5. Posedon shkathtësi profesionale për përpilimin e instrumenteve, standardeve dhe raporteve për notim në nivel kombëtar.
6. I përmirëson politikat shkollore për notim.
7. Di si ta rrisë efektivitetin e notimit, duke përfshirë edhe shfrytëzimin e analizës statistikore.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Përpilon instrumente për vlerësimin e lëndës dhe i përmirëson duke u bazuar në analizën e karakteristikave të matjes;
- I ndihmon kolegët për përmirësimin e instrumenteve për notim;
- Punon në ekipe për përpilimin e dokumenteve për notim në nivel kombëtar.
- Merr pjesë aktive në punën e ekipore për ndërtimin e politikës shkollore për notim.
- Merr pjesë në ekipe për zhvillimin e standardeve dhe strategjive për notimin e të rriturve që përcjellin arsimin profesional me korrespondencë²⁸.
- Trajton përfaqësues të punëdhënësve për të kontrolluar arritjet e aftësisë praktik të nxënësve²⁸.
- Bën analiza statistikore të të arriturave të nxënësve në shkollë për lëndën mësimore, i ndërlidhë me faktorët e mundshëm dhe propozon masa për përmirësimin e suksesit.



²⁸ Këto kompetenca kanë të bëjnë me arsimtarët që mbajnë mësim praktik dhe arsimtarët e lëndëve teorike-profesionale në shkollat e mesme profesionale.



III. KRIJIM I MJEDISIT STIMULUES PËR NXËNIE

Arsimtari-këshilltar ka siguruar që klasa e tij të jetë shembull për mjedis përkatës të punës, si nga aspekti i pajisjes, ashtu edhe nga aspekti i klimës motivuese për nxënie dhe atmosferës së punës gjatë mësimit. Njëherësh ai është i përkushtuar që të kontribuojë që e gjithë shkolla të jetë shembull i një shkolle në të cilën të gjithë ndjehen të sigurt, ndjehen mirë dhe vazhdimisht kanë sfida për nxënie. Angazhohet në edukimin dhe përfshirjen e kolegëve, prindërve dhe subjekteve tjera nga bashkësia për përmirësimin e kushteve për nxënie në shkollë dhe rritje të sigurisë së nxënësve në shkollë dhe në bashkësinë lokale. Për këtë qëllim inicion nisma dhe realizon aktivitete për rritjen e sigurisë fizike të nxënësve në shkollë dhe në bashkësi, si dhe për ndërtimin e sistemit të vlerave, ku zgjidhja jo e dhunshme e konflikteve dhe toleranca do të jenë mënyrë dominuese e sjelljes. Arsimtari-këshilltar është lider i bashkimit të shkollave nga mjedisi në aktivitete të përbashkëta, me çka kontribuon në përmirësimin e klimës së përgjithshme për bashkëpunim dhe respekt të ndërsjellë.

III. KRIJIM I MJEDISIT STIMULUES PËR NXËNIE

Nën-fusha: KRIJIMI I MJEDISIT TË SIGURT DHE STIMULUES PËR NXËNIE

ARSIMTAR - KËSHILLTAR...



KOMPETENCA

1. Nxitë aktivitete për mjedis stimulues dhe të sigurt.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Organizon punëtori, takime për mjedis të sigurt dhe stimulues për nxënie.
- Ndërmerr aktivitete për të përmirësuar sigurinë në shkollë dhe rrethinë.
- Inicion, organizon dhe zbaton aktivitete të përbashkëta për bashkëpunim ndërshkollorë të nxënësve dhe arsimtarëve.



III. KRIJIM I MJEDISIT STIMULUES PËR NXËNIE

Nën-fusha: KRIJIMI I KLIMËS POZITIVE SHKOLLORE

ARSIMTAR - KËSHILLTAR...



KOMPETENCA

2. Krijon klimë në shkollë dhe jashtë saj që karakterizohet me transparencë, respekt dhe bashkëpunim.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Inicion diskutime dhe iniciativa për hartimin e strategjive për nxitjen e motivimit për punë të nxënësve dhe arsimtarët.



IV. INKLUZION (PËRFSHIRJE) SOCIAL DHE ARSIMOR

Arsimtari-këshilltar është i njohur si lider i përfshirjes (inkluzionit) në shkollë, por edhe në bashkësinë më të gjerë. Ai di dhe shfrytëzon qasje të ndryshme për identifikimin dhe plotësimin e nevojave arsimore të grupeve të ndryshme të nxënësve dhe veçanërisht është i ndjeshëm për nevojat e grupeve të ndjeshme të nxënësve. Me kolegët ndërton strategji dhe realizon aktivitete në të cilat, në mënyrë përkatëse, i përfshin të gjithë nxënësit. Nxënësit janë të përfshirë në aktivitete për nxënie, në aktivitetet e lira të nxënësve dhe në aktivitete në bashkësinë që i realizon shkolla. Veçanërisht angazhohet në ndryshimin e qëndrimeve të mjesistrit ndaj grupeve të marginalizuara të nxënësve duke treguar mënyra se si ata mund të përfshihen në bashkësi.

Njohuritë, përvojën dhe përkushtimin e tij e shfrytëzon edhe përmes përfshirjes në aktivitete për përmirësimin e politikave dhe praktikave arsimore në nivel rajonal dhe nacional.

IV. INKLUZION (PËRFSHIRJE) SOCIAL DHE ARSIMOR

Nën-fusha: INKLUZION (PËRFSHIRJE) SOCIAL DHE ARSIMOR

ARSIMTAR - KËSHILLTAR...



KOMPETENCA

1. Kontribuon për përfshirjen e nxënësve në komunitetin më të gjerë.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Ndërmerr aktivitete në nivel të shkollës dhe bashkësisë më të gjerë, për tejkalimin dhe eliminimin efektiv të materialeve, situatave dhe aktiviteteve që nuk promovojnë barazi.
- Propozon dhe ndërmerr aktivitete për përfshirjen aktive të nxënësve në jetën dhe punën e bashkësisë lokale, pavarësisht nga aftësitë, prejardhja dhe kushtet e tyre socio - ekonomike.
- Merr pjesë në përpilimin e dokumenteve për të përmirësuar arsimin gjithëpërfshirës (inkluziv) në nivel qendror dhe lokal.
- Punon në tejkalimin e paragjytimeve për përfshirjen e nxënësve me nevoja të posaçme arsimore në trajnimin praktik tek punëdhënësi²⁹.

²⁹ Këto kompetenca kanë të bëjnë me arsimtarët që mbajnë mësim praktik dhe arsimtarët e lëndëve teorike-profesionale në shkollat e mesme profesionale.

V. KOMUNIKIM DHE BASHKËPUNIM ME FAMILJEN DHE BASHKËSINË

Arsimtari–këshilltar është i njohur në bashkësinë më të gjerë shoqërore, si person që kontribuon drejt ndërtimit të partneritetit dhe përgjegjësisë shoqërore ndërmjet shkollës dhe bashkësisë lokale, në atë mënyrë që i animon subjektet e ndryshme në bashkësinë që të përfshihen në punën e shkollës dhe të kontribuojnë për të arriturat e nxënësve, nga njëra anë, e nga ana tjetër i promovon të arriturat e shkollës dhe aktivitetet e përbashkëta të shkollës me bashkësinë lokale. Duke i shfrytëzuar shkathtësitë për komunikim, por gjithashtu duke i ditur edhe karakteristikat dhe nevojat e subjekteve të ndryshme me të cilët komunikon arsimtari–këshilltar, ia arrin të krijojë lidhje të ngushta mes shkollës dhe subjekteve të bashkësisë lokale që e dallojnë shkollën si shkolla “jonë”, ndërsa arsimtarët dhe nxënësit kujdesen për bashkësinë “tonë” lokale dhe banorët e saj.

Krahas kësaj, ai kryesisht është shembull i arsimtarit që di në çdo situatë të reagojë në mënyrë përkatëse: në mësim dhe jashtë tij, në komunikim me nxënësit, prindërit dhe kolegët, por edhe në komunikim me anëtarët e bashkësisë më të gjerë shoqërore.

V. KOMUNIKIM DHE BASHKËPUNIM ME FAMILJEN DHE BASHKËSINË

Nën-fusha: BASHKËPUNIM ME FAMILJET E NXËNËSVE
DHE BASHKËSINË LOKALE

ARSIMTAR - KËSHILLTAR...



KOMPETENCA

1. Ndërton partneritete mes shkollës me bashkësisë lokale për përgjegjësi shoqërore.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Inicion dhe organizon projekte me bashkësinë lokale dhe familjen për përmirësimin e arritjeve të nxënësve dhe jetës në bashkësi.
- Ndërton strategji dhe promovon punën e shkollës dhe të arriturat e nxënësve në bashkësinë më të gjerë.
- Krijon partneritet mes shkollës dhe kompanive lokale dhe më gjerë³⁰.

³⁰ Këto kompetenca kanë të bëjnë me arsimtarët që mbajnë mësim praktik dhe arsimtarët e lëndëve teorike-profesionale në shkollat e mesme profesionale.

VI. ZHVILLIM PROFESIONAL DHE BASHKËPUNIM PROFESIONAL

Arsimtari-këshilltar është shembull i profesionistit që investon shumë në zhvillimin personal profesional dhe shkencor. Si rezultat i asaj ai përfiton arsim plotësues formal, përfshihet në forma të ndryshme të arsimit joformal, jo vetëm për fushën e lëndës, por edhe për problematikën më të gjerë arsimore. Ai, po ashtu, i prezanton njohuritë, pikëpamjet dhe qëndrimet e veta profesionale në botime profesionale dhe shkencore dhe në tubime, dhe në këtë mënyrë kontribuon për zhvillimin profesional të të punësuarve tjerë në arsim. Ka njohuri, shkathtësi dhe është i motivuar të kontribuojë për zhvillimin profesional të kolegëve, është lider i aktiviteteve për planifikim, realizim dhe vlerësim të zhvillimit profesional në shkollë, me ç’rast përfshihet edhe në aktivitete për zhvillim profesional në nivel rajonal dhe kombëtarë.

Është praktikues reflektiv që di të analizojë, studiojë dhe përparojë praktikën personale. Dëshiron dhe di t’i udhëheqë kolegët në përparimin e praktikës së tyre, është iniciator dhe është udhëheqës i ekipeve bashkëpunuese për mësim në rajon dhe në bashkësi tjera profesionale për nxënie.

Ka shkathtësi të mira për punë me të moshuar dhe prandaj ka rolin e trajnuesit të trajnuesve dhe mentor i arsimtarëve fillestar.

VI. ZHVILLIM PROFESIONAL DHE BASHKËPUNIM PROFESIONAL

Nën-fusha: ZHVILLIM PROFESIONAL

ARSIMTAR - KËSHILLTAR...



KOMPETENCA

1. Zhvillon dhe realizon strategji dhe dokumente për zhvillim profesional në nivel rajonal dhe kombëtar.
2. Vazhdimisht përsoset në aspekt profesional dhe shkencor përmes pjesëmarrjes në forma të ndryshme të nxënies formale dhe joformale në fushën e lëndës apo fushën e arsimit.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Është anëtar i grupeve punuese për përpilimin e dokumenteve për zhvillim profesional me interes rajonal dhe kombëtar.
- Njohuritë profesionale deri tek të cilët ka arritur përmes hulumtimeve i prezanton në shtypin profesional apo tubime profesionale.
- Merr pjesë në punën e grupit për vlerësimin e avancimit profesional dhe avancimit në karrierë të kolegëve me titullin arsimtarë-mentorë.
- Merr pjesë në përzgjedhjen, përshtatjen dhe përpilimin e instrumenteve për vlerësim të arsimtarëve në nivel të shkollës.
- Posedon diploma, çertifikata dhe / ose lloje tjera të provave.
- Posedon diplomë për nivelin e zhvillimit shkencor (magjistraturë dhe doktoratë).



VI. ZHVILLIM PROFESIONAL DHE BASHKËPUNIM PROFESIONAL

Nën-fusha: BASHKËPUNIM PROFESIONAL

ARSIMTAR - KËSHILLTAR...



KOMPETENCA

3. Krijon dhe udhëheqë ekipe rajonale për nxënie dhe me rrjete profesionale për shkëmbimin e përvojave
4. Zhvillon programe për zhvillimin profesional në shkollë.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Transmeton përvojat dhe njohuritë e veta tek arsimtarët e shkollave tjera.
- Realizon trajnime me karakter rajonal dhe / ose shtetëror.
- Bashkëpunon me fakultete dhe organizata të tjera profesionale në realizimin e projekteve kërkimore.
- Është mentor i arsimtarëve.



